



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë

“Master i Shkencave në:

“Menaxhim”

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ermira QOSJA

Prof. Asoc. Dr. Elena KOKTHI

Maj / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “Menaxhim”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Administrim Biznes
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave “Menaxhim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 652 dt.14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022: 7 PAE / 3PAK Bazuar në ngarkesën mësimore rezultojn: 95%PAE ; 5% PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 16 studentë; 2020-2021 18 studentë; 2021-2022 20 studentë; 2022-2023 22 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit (UE) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.414 dt.12.11.1991. UE i është akorduar akreditimi institucional me Vendim Nr. 49, datë 27.11.2020, me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.11.2026. Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij pesë fakultete emërtuar si vijon:

- Fakulteti i Shkencave Humane
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- Fakulteti i i Ekonomisë
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Në historinë e UE, Departamenti i Administrim-Biznesit është hapur me vendimin Nr. 369, dt. 10.07.1995 të Ministrisë së Arsimit, si pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Në vitin 2002 përmes VKM Nr. 371, krijohet Fakulteti Ekonomik si njësi kryesore brenda UE, në të cilin Departamenti i Administrim-Biznesit përbën njësinë e parë bazë. Departamenti i Administrim ofron aktualisht tre programe studimi: Bachelor në Administrim- Biznes; Master Profesional në Administrim- Biznes dhe Master i Shkencave në Menaxhim, i cili është hapur bazuar në VKM Nr. 652 dt.14.09.2011

Programi në vite është përmirësuar, si benchmarking i tij ka shërbyer Msc Administrim Biznes i Fakultetit Ekonomik të UT si dhe ka pësuar ndryshime në përputhje me Ligjin e fundit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, udhëzimet që pasuan atë, dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit MSHM janë në përputhje të plotë me ato të UE dhe kanë të bëjnë me: suksesin e studentëve në tregun e punës. Programi ,është konceptuar dhe hartuar me lëndë dhe module, përmban 120 ECTS dhe zhvillohet në dy vite të plota akademike.

Departmenti ka në përbërje 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët: 2 me titullin "Professor", 3 "Profesor i Asociuar" dhe 3 Doktor shkencash duke plotësuar kriteret ligjore.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Prof. Asoc. Dr. Elena Kokthi. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim”, i ofruar nga Departamenti i Administrim- Biznesit të Fakultetit të Ekonomik pranë Universitetit të Elbasanit, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në UE, u realizua në datën 16 dhe 17 Janar 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në UE, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit të Administrim-Biznesit dhe Dekanen e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, zvdekanët të cilët mbulojnë: Procesin Mësimor dhe Kerkimin Shkencor; si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MSHM, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.04.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 2/55 Prot, datë 24.04.2023. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” më datë 02.05.2023 njofton me anë të shkresës me Nr. 642/30, datë 28.04.2023, “Kthim përgjigje tuajës nr.2/55, datë 24.04.2023”, ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e jashtëm për programin e studimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Menaxhim”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Departamenti i Administrim Biznesit i Fakultetit Ekonomik në vizionin e tij për programin MSHM ka synuar të krijojë një model bazuar në përvojën e institucioneve më të mira të arsimit të lartë në Shqipëri, të marrë në konsideratë nevojat e Qarkut të Elbasanit përmes bashkëpunimeve me institucionet e tij, si dhe përvojën e bashkëpunëtorëve ndërkombëtarë. Ruajtja dhe konsolidimi i vlerave kombëtare shprehet dhe në nenin 2 të Statutit të UE, por konfirmohet dhe në takimin me Dekanen Prof. Asoc.Dr. I. S dhe Përgjegjësin e Departamentit Prof. Asoc.Dr. Gj. Sh, ku shprehet qartë që ky program synon investimin e duhur në kapitalin human, që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm të sipërmarrjeve, lidhjen universitet-industri dhe është një kontributor i rëndësishëm për përgatitjen e specialistëve për tregun e punës në Qark e më gjerë. <i>Dokumenti 3: Raporti i GVB</i> <i>Dokumenti 1.1. Statuti i UE</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi MSHM është hartuar në përputhje me Misionin e UE, për të krijuar, zhvilluar, përcjellë dhe mbrojtë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, për të formuar specialistë të lartë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Harmonizimi i teorisë me nevojat e tregut shqiptar dhe atij rajonal është bërë e mundur përmes njohurisë dhe aftësisë së stafit akademik dhe kompetencës së tyre për t'u përshtatur me rastet studimore, projektet apo mikrotezat e kompanive shqiptare dhe të ekonomisë shqiptare dhe rajonale. <i>Dokumenti 3: Raporti i GVB</i> <i>Dokumenti 1.1. Statuti i UE</i>

	<p><i>Dokumenti 1.18. Strategji e zhvillimit të Departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve në shqip dhe anglisht</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Në takimin me Dekanen e Fakultetit dhe drejtuesin e departamentit përforcuam mendimin se programi MSHM është në përputhje të plotë me vizonin e UE dhe të FE dhe sukcesi i tij në vite ka qenë i qenësishëm.</p> <p>Departamenti i Administrim Biznesit është hapur me vendimin Nr.365 të vitit 1995 të Ministrisë së Arsimit, ndërsa program i studimit MSHM është hapur bazuar në VKM Nr. 652 dt.14.09.2011. Të bindur për avantazhet që programi dhe departamenti ofron përkundrejt programeve master të fakultetit, drejtuesit e FE dëshmuar që programi MSHM shërben nga njëra anë formim të profesionistëve për tregun e punës lokal, kombëtar dhe global, por dhe nga ana tjetër formim të kërkuesve të ardhshëm dhe kjo e mundësuar nga kurrikula dhe metodologjitë e përdorura në mësimdhënie.</p> <p><i>Dokumenti 1.19: Vendimi i hapjes së departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 2: Mendimi Dekanit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.1. Statuti i UNEL</i></p> <p><i>Dokumenti 2 në dokumentat shtesë: VKM Nr. 652/2011</i></p> <p><i>Dokumenti 1.18. Strategji e zhvillimit të Departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve në shqip dhe anglisht</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të RVB, Strategjisë së Departamentit, Planit Mësimor, Silabuseve të lëndëve, evidentohet që programi MSHM është hartuar duke marrë në konsideratë formimin e specialistëve me aftësi menaxheriale, për të punuar në SME dhe ndërmarrjet e mëdha shqiptare, por dhe për të qenë të përgatitur për një treg më global. Gjatë takimit me stafin akademik të Departamentit të Administrim Biznesi, u diskutua sesi ata përcjellin njohuritë që vijnë përmes teksteve të huaja dhe realitetit shqiptar përmes rasteve studimore, projekteve, të ftuarve në auditor dhe vizitave në biznese.</p> <p><i>Dokumenti 3: Raporti i GVB</i></p> <p><i>Dokumenti 1.18. Strategji e zhvillimit të Departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve në shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit MSHM</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ bazuar në sa më lart vlerëson se Departamenti i Administrim Biznesit i FE ofron programin e studimi MSHM në përputhje me misionin dhe qëllimin e UE, duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Ky standard përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Departamenti i Administrim Biznesit është një nga departamentet e hershme të UE dhe në vite ka arritur të krijojë një përvojë pozitive brenda universitetit dhe më gjerë. Në përbërje të departamentit ka staf akademik që mban titullin Prof., Prof.Asoc dhe Dr. në fushën e menaxhimit, ndërkohë në vite kanë arritur të ndërtojnë dhe mbajnë një bashkëpunim shumë pozitiv dhe me profesoratin e Fakultetit Ekonomik të UT, gjë që ka kontribuar në përmirësimin e kurrikulave dhe në avancimin akademik të stafit. Programi MSHM tashmë ka krijuar një ekperiencë mbi 10 vjeçare në Arsimin e Lartë në Shqipëri, ekperiencë e cila është pasuruar dhe përmes projekteve europiane dhe ndërkombëtare në të cilin departamenti dhe stafi i tij është përfshirë.</p> <p>Strukturat përgjegjëse: Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili ka 5 (pesë) departamente dhe 1 Qendër:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Administrim Biznes; 2. Departamenti Ekonomiks; 3. Departamenti Financë Kontabilitet; 4. Departamenti i së Drejtës; 5. Departamenti Marketing dhe Inxhinieri; 6. Qendra për Kërkime dhe Zhvillime Ekonomike;

	<p>Burimet njerëzore: Stafi akademik bazuar në CV-të rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të menaxhimit.</p> <p>Nga të dhënat që jepen në DVV, tab. Nr. 1 RVB, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 109 pedagogë, nga të cilët 44 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 11 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 28 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 Asistent Lektorë me Msc; dhe 65 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 4 kanë titullin “Profesor”, 6 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 17 kanë gradën Dr./PhD. dhe 38 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa në departament për vitin akademik 2021-2022, janë 7 lektorë, si personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor”, 3 me titullin “Profesor i Asociuar”, dhe 3 “Doktorë”. Në departament janë të angazhuar dhe 10 personel akademik me kontratë (PAK), nga të cilët janë 2 me titullin “Profesor”, 2 “Doktorë” dhe 6 me “Master i Shkencave”.</p> <p><i>Dokumenti 1.19: Vendimi i hapjes së departamentit</i></p> <p><i>Dokumenti 2 në dokumentat shtesë: VKM Nr. 652/2011</i></p> <p><i>Dokumenti 3: Raporti i GVB. Tabelat 2, 4, 6, 7, 12, 19</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi Msc në Menaxhim është në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UE, që përcaktojnë Departamentin e Administrim Biznesit si njësi bazë të njësisë kryesore Fakulteti Ekonomik.</p> <p>Struktura e programit është në përputhje të plotë me Statutin e UE (Kreu 7, Neni 50) dhe organizimi i studimeve bëhet bazuar në disa nene të Rregullores së Fakultetit Ekonomik (kreu II, Neni 12 dhe një sërë nenesh të kreu III).</p> <p><i>Dokumenti 1.1: Statuti UE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit të studimit MSHM</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e</p>	<p>Bazuar në “Strukturën e programeve të FE për të treja ciklet e studimit”, programi MSHM përputhet plotësisht me fushën akademike dhe të kërkimit të Departamentit të Administrim Biznesit. Qëllimi i formimit në këtë program studimi ka të bëjë jo vetëm me zhvillimin e ekonomisë lokale dhe kombëtare, por gjykojmë që synon të përgatisë studentët për një botë globale. Pedagogët gjatë takimit u shprehën se si përmes programit,</p>


<p>studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>gërshetimit të lokales dhe globales, përpiqen të krijojnë një strukturë programi që përgatit studentët si me aftësi menaxheriale që koha kërkon</p> <p><i>Dokumenti 3.13: Strukturën e programeve të FE për të treja ciklet e studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit të studimit MSHM</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve në shqip dhe anglisht</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>NA</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Qendra e Karrierës është një njësi që po merr jetë në UE dhe në bashkërendim me departamentin/fakultetin po përpiqen që krahas marrëveshjeve me institucione/organizata dhe orientimit të studentëve në intershipe dhe punësim, të luajnë brenda universitetit një rol më proaktiv dhe përmes trajnimeve profesionale. Gjatë vizitës në institucion, stafi i Zyrës së Karrierës na informoi për një sërë aktiviteteve me këtë qëllim të bërë në vitin e fundit akademik (pas kthimit të studentëve në auditore pas pandemisë)</p> <p><i>Dokumenti 1.13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.3: Rregulloret e Organizimit dhe funksionimit të UE</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që programi i studimit MSHM është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit

të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programi MSHM për vetë përmbajtjen e lëndëve që ka menaxhohet plotësisht nga Departamenti i Administrim Biznesit. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015, Statutin e Rregulloren e UE, në Rregulloren e Fakultetit dhe të Departamentit, ky i fundit ushtron kompetencat e tij në lidhje me hapjen, riorganizimin, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë.</p> <p>Në funksion të mbarëvajtjes së punës në administrimin e MSHM, Drejtuesi i departamentit është përcaktuar dhe koordinator i programit, me qëllim administrimin më efikas të tij dhe përmirësimin e vazhdueshëm, përmes sugjerimeve që sjell në departament. Në veprimtarinë e Departamentit vend të vecantë zënë dhe mbledhjet dhe vendimet që merren, të cilat pasqyrohen në proces –verbalet e mbledhjeve.</p> <p><i>GVJ sugjeron që proces –verbalet e mbledhjeve të mund të zbardhen e të mbahen si dokumentacion i rregullt në kohë.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.1: Statuti UNEL</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e Fakultetit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.3: Rregullore e Organizimit dhe funksionimit të UNEL</i></p> <p><i>Dokumenti 1.15: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Administrim Biznesit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.12: Analiza Vjetore Institucionale 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 3 në dokumentat shtesë: Procesverbal mbledhesh dhe vendimesh</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë</p>	<p>Eksperienca dhe tradita që Fakulteti Ekonomik ka brenda UE në shumë vite, krijon oportunitete për bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit. Nëse do t'i referoheshim dokumentit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të UE, evidentohet që shumë prej marrëveshjeve janë të fokusuara në fushat që FEUE mbulon duke përbërë një hapësirë shumë të frytshme për punën</p>

<p>vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>shkencore, projektet ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimin e këtij fakulteti. Gjithashtu, në RVB – <i>tabela 19 dhe 20</i> vihet re që stafi i departamentit të menaxhimit ka një përfshirje të konsiderueshme në mobilitete, projekte lokale dhe ndërkombëtare, si dhe në angazhimin në punë shkencore dhe botime. FEUE dhe Departamenti kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me organizata publike dhe kompani private sic shihet në dokumentet 1.13 dhe 1.14.</p> <p>Roli i departamentit është i rëndësishëm, megjithatë <i>Departamenti i Administrim- Biznesit dhe FEUE kanë mundësi për më shumë bashkëpunime me industrinë dhe më shumë efikasitet në bashkëpunim me ta. Duhet ndërtuar skemat formale të bashkëpunimit me industrinë dhe duhen gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/intershipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe startupeve të reja, patentan etj.</i></p> <p><i>Dokumenti 3: Raporti i GVB. Tabelat 19 dhe 20</i></p> <p><i>Dokumenti 1.13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.14. Lista e marrëveshjeve për praktikant</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>FE-UE është një pikë referimi për institucionet publike, organizatat e rëndësishme në rajon, kompanitë e mëdha të biznesit, sistemin bankar etj. Për këto arsye, po dhe për faktin që një pjesë e pedagogëve gëzojnë reputacion në jetën ekonomike dhe sociale të Elbasanit dhe ata ndërveprojnë me organizatat në mënyrë informale, marrëveshjet formale dhe lista e institucioneve bashkëpunuese është e kufizuar. Gjatë takimeve në FEUE, studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në formimin e tyre me të ftuar, gjithashtu në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karriere të tyre. Qendra e Karrierës kntribuon gjithashtu ndonëse në hapat e para të saj, por ka ende shumë hapësirë për të kontribuar e shkuar përpara në raportet me tregun e punës.</p> <p><i>Dokumenti 1.13: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.14. Lista e marrëveshjeve për praktikant</i></p> <p><i>Dokumenti 5.14: Harta e punësimit të studentëve</i></p>

	<i>Dokumenti 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen e ËEB</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Në nivel institucional, çdo vit akademik përpilohen raportet vjetore të departamentit, fakultetit dhe universitetit si dhe raportet nga pytesorët me studentët. Një dokument tjetër i rëndësishëm është Strategjia e Departamentit të administrim-biznesit, por që nga <i>pikëpamja formale nevojitet të ketë datë të miratimit në Departamenti dhe periudhë kohore</i></p> <p>Ndërkohë në nivel program studimi, një pjesë e mbledhjeve të departamentit trajtojnë çështje dhe problematika që lidhen me MSHM.</p> <p><i>Dokumenti 1.12: Analiza Vjetore Institucionale 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 1.23: Analiza Vjetore Fakultetit Ekonomik 021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 1.24: Analiza Vjetore Departamentit të Administrim-Biznesit 021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 1.18: Strategjia e Zhvillimit të departamentit të administrim-biznesit</i></p>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson pozitivisht institucionin në lidhje me bashkëpunimet me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotërisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Plotërisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi MSH në Menaxhim; është hapur me VKM Nr. 652 dt.14.09.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullues, bazuar në VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018, azhornuar më tej me VKM Nr. 879, dt.18.12.2019 janë reflektuar në formën që programi paraqet sot në momentin e akreditimit.</p> <p>Qëllimi i programit MSHM është të formojë dhe aftësojë individë për tregun e punës dhe t'u krijojë atyre avantazh konkurrues në të. Mbështetur në të gjithë dokumentacionin e paraqitur, MSHM karakterizohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 vite akademike/4 semestra; - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - ngarkesa mësimore 1210 orë në auditor; 1840 orë jashtë tij; -forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. <p>Programi strukturohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 2 lëndë, 12 ECTS- 10% e krediteve (standardi 15%-20%) ; - Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: 9 lëndë, 61 ECTS- 50.8% e krediteve (standardi 50%-55%) - Kategoria C - lëndë ndërsiplinore 3 lëndë, 19 ECTS – 15.8% e krediteve (standardi 12-15%) - Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika 12 ECTS, 10% ECTS, e krediteve (standardi 10%-15%) ; - Kategoria E – detyrime përmbyllëse: Diploma 16 ECTS, 13.3% e ECTS (standardi 13%-15%) - Diploma dhe suplementi i saj, janë hartuar në përputhje me legjislacionin; <p>Silabuset e lëndëve janë formuluar në përputhje me udhëzimet dhe përmbajnë elementët e koncepteve bazë /rezultatet e të nxënit / temat / kodin e etikës / orët në auditor leksion / seminar / format e kontrollit të dijes / frekuentimin / literaturën. Silabuset janë formuluar në shqip dhe anglisht.</p>

	<p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 9</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>MSHM synon të formojë dhe aftësojë studentët në një spektër relativisht të gjerë të kompetencave menaxheriale dhe t'u krijojë avantazh konkurrues në tregun e punës, lokal dhe kombëtar.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e tij shprehen një lloj rezistence ndaj ndryshimeve në përmbajtjen e programit. Ndërkohë u dakordësuam që studimi i tregut i paraqitur mund të ketë vlerë për analiza më të gjera, por duhet të kishte një sens më konkret e më të fokusuar në rastin e programit që akreditohet</i></p> <p><i>Spektri i formimit është relativisht i gjerë (silabuset) dhe kjo shërben në kushtet e një tregu të vogël si Shqipëria, por në transformimet e reja dhe shumë dinamike që po pëson menaxhimi dhe tregu i punës sot, kërkohet më shumë specializim në drejtime të veçanta. Programi nën këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm mund të kishte prezencë të më shumë elementëve inovacion, digjitalizim dhe marketing.</i></p> <p><i>Dokumenti 5.19: Studimi i tregut</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Praktika mësimore zhvillohet në semestrin e 2 të vitit të dytë në përputhje me Rregulloren e Fakultetit Ekonomik neni 31 “Organizimi i praktikave profesionale/mësimore”.</p> <p>Nga pikëpamja e dokumentacionit, departamenti ka përgatitur “Paketën e praktikës profesionale”, vlen të theksohet që gjatë takimit me stafin e departamentit dhe studentët u dakordësuam që <i>praktika reflekton problematikë të njëjtë dhe me shumë universiteteve të tjera, duke qëndruar mes një detyrimi ligjor nga njëra anë dhe fiktivitetit nga ana tjetër.</i></p> <p>Në lidhje me detyrimin përmblyës, punimin e diplomës e cila në programin mësimor mban një peshë prej 16 ECTS, departamenti ka përpiluar dokumentacionin e plotë: Manualin e punimit, Formatin e diplomes si dhe në përputhje me ligjin Suplementin e Diplomës për programin MSHM.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi u shpreh që në temën e punimit të diplomës përpunoi ta lidhin me interesin profesional të</p>

	<p>studentit, përsa i përket <i>çështjes së plagjiaturës dukej që mbetej në ndërgjegjën e pedagogut udhëheqës dhe të përgjegjshmërisë profesionale të pedagogut oponent.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i></p> <p><i>Dokumenti 1.25: Paketa e praktikës mësimore MSHM</i></p> <p><i>Dokumenti 3.5: Manuali i punimit të Diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 3.7: Formati i punimit të Diplomës (Rregullorja e diplomimit)</i></p> <p><i>Dokumenti 3.5: Manuali i punimit të Diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 3.8: Model i Sulentit të Diplomës</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>NA</p>

<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Pas miratimit të Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri ne vitin 2015 dhe një sërë aktesh nënligjore që e pasuan atë si VKM Nr 41 dt.24.01.2018 dhe VKM Nr 879, dt. 18.12.2019, Departamenti i Administrim biznesit ka përshtatur të gjithë elementët strukturore të programit, planin mësimor, silabuset janë në shqip dhe anglisht sipas VKM Nr. 41.</p> <p>Në lidhje me pranimin e studentëve, respektohen të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të MAS dhe qeverisë shqiptare. Brenda institucionit UE, Departamenti propozon pranë dekanatit kuotat dhe kriteret e pranimin të studentëve në programin MSHM, bazuar në Rregulloren e Fakultetit.</p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i></p> <p><i>Dokumenti 1.20: Vendim për miratimin e kuotave të pranimin në programin e studimit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.21: Vendim për miratimin e kriterëve të pranimin në programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit MSHM ka patur gjithnjë si udhërrëfyes programin e MSHAB të Fakultetit Ekonomik të UT, jo vetëm për përvojën por dhe për faktin që në vite profesorati i FEUT ka kontribuar në mësimdhënie, në përmirësimin e programit dhe në hartimin e silabuseve</p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor I programit</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 9 – Programi mësimor</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p> <p><i>Dokumenti 1.18. Strategjia e zhvillimit të departamentit të AB</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve¹, programi i studimit MSHM i përket nivelit 7. Kodifikimi i lëndëve të programit, është pasqyruar në në dokumentin 1.9 – Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të programit MSHM. Si rregull përdoren akronimet e programit të studimit MSHM dhe të lëndëve përkatëse dhe më pas vitin kur zhvillohet lënda.</p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.9: Kodifikimi i lëndëve të programit MSHM</i></p>

¹ https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010_korniza_shqiptare_e_kualifikimeve.pdf

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	MSHM nuk është program i përbashkët			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se në lidhje me standardin “Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore” duhet të rishikohet për saktësim në Planin Mësimor ngarkesa jashtë auditorit, dhe të synohet në afatshkurtër përshtatja e programit më dinamikat e tregut dhe sistemimi i plotë i silabuseve në përputhje me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, do të duhet të përdoren programet e antiplagjaturës për punimet e diplomës dhe detyrat, si dhe të bëhen përpjekje për funksionalizimin e praktikës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UE është akredituar me Vendimin Nr 49 të vitit 2020 të Bordit të Akreditimit për 6 vite. Fakulteti Ekonomik është një nga 5 fakultetet e UE hapur me VKM Nr, 307 të vitit 2002. Fakulteti Ekonomik i Universiteti “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit ka në përbërje të tij, 6 njësi si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamentin e Administrim Biznesit; 2. Departamentin e Marketingut dhe Inxhinierisë; 3. Departamentin e Financë – Kontabilitetit 4. Departamentin e Ekonomiksit 5. Departamentin e së Drejtës

	<p>6. Qendrën Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi</p> <p>Fakulteti Ekonomik ofron programe studimi në dy cikle: Bachelor dhe Master dhe <i>duke u përpjekur të ketë një ndërdisiplinartitet pak specifik (Departamenti Marketing dhe Inxhinieri si dhe Departamenti i së Drejtës brend FE).</i></p> <p>Departamenti i Administrim Biznesit është hapur me vendimin Nr 369 të vitit 1995, natyrisht në kohë nga pikëpamja strukturore ka reflektuar ndryshimet ligjore në Arsimin e Lartë, aktualisht departamenti mbulon 3 programe studimi.</p> <p><i>Në tabelën 1 të RVB paraqitet numri i personelit për çdo njësi bazë të FEUE, evidentohet që të 6 njësitë kanë në përbërje 7 PAE duke plotësuar kriterin ligjor në lidhje me numrin.</i></p> <p><i>Në tabelen 2 të RVB evidentohet që Departamenti AB ka 7 PAE (duke plotësuar kriteret ligjore) nga të cilët:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria profesor - 4 (1 Prof.Dr. dhe 3 Prof.Asoc.Dr - Kategoria Doktor Shkencash - 3 <p>dhe 10 PAK, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria profesor - 2 - Kategoria Doktor Shkencash - 2 - Kategoria Doktor në process – 1 - Kategoria Msc - 5 <p>Në programin e studimit MSHM, sipas Tabelës 6 në RVB për vitin 2021-2022 evidentohet të angazhohen 7 PAE/2 PAK , pra në raportin 78% PAE dhe 22 % PAK/.</p> <p><i>Doumenti 1.6. Çertifikatë akreditimi institucional</i></p> <p><i>Dokumenti 1.11: Struktura e organizimit UNEL</i></p> <p><i>Dokumenti 1.19: Vendimi për hapjen e departamentit AB</i></p> <p><i>Dokumenti 1.21: Vendimi për hapjen e FEUL</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 1, 2 dhe 4.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar</p>	<p>Plani mësimor i programit MSHM është strukturuar në mënyrë të tillë që praktikat mësimore zhvillohen pranë organizatave. Në Paketën e praktikës mësimore për programin MSHM, qartë duket që gjithshka është konceptuar rreth praktikës në një intitucion.</p>

personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Silabuset e lëndëve nuk përmbajnë laboratore, në këto rrethana, Departamenti i Administrim – Biznesit si njësi bazë nuk angazhon personel ndihmës akademik.</p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.25: Paketa e praktikës mësimore për programin MSHM</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve të MSHM në shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Në RVB gjendet e shprehur që Koordinator i programit të studimit është Drejtuesi i Departamentit, fakt që u konfirmua dhe gjatë takimit me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit.</p> <p>GVJ evidenton mungesën e Rregullores së programit të studimit MSHM, e cila u kërkua të paraqitej dhe gjatë vizitës në institucion, ndërkohë që Drejtuesi i Departamentit u shpreh për rolin i tij në koordinimin e të gjitha veprimtarive.</p> <p><i>Dokumenti 3: RVB</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi” në Departamentin AB i plotëson. Mungon Rregullorja e Programit</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon	<p>Programi Msc në Menaxhim, mbështetur në të gjithë dokumentacionin e paraqitur, karakterizohet:</p> <p>- 2 vite akademike/4 semestra;</p>

<p>informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - kredite për semester 30/ për vit akademik 60; - ngarkesa mësimore 1210 orë në auditor; 1840 orë jashtë tij; - forma e mësimdhënies: Leksione / seminare / ushtrime / projekte / detyra kursi. <p>Programi strukturohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A – lëndë të formimit të përgjithshëm; 2 lëndë, 12 ECTS- 10% e krediteve (standardi 15%-20%) ; - Kategoria B – lëndë të formimit karakterizues: 9 lëndë, 61 ECTS- 50.8% e krediteve (standardi 50%-55%) - Kategoria C - lëndë ndërsipinore 3 lëndë, 19 ECTS – 15.8% e krediteve (standardi 12-15%) - Kategoria D – lëndë të formimit plotësues: Praktika 12 ECTS, 10% ECTS, e krediteve (standardi 10%-15%) ; - Kategoria E – detyrime përmbajtëse: Diploma 16 ECTS, 13.3% e ECTS (standardi 13%-15%) - Diploma dhe suplementi i saj, janë hartuar në përputhje me legjislacionin; <p>Silabuset e lëndëve përmbajnë elementët e koncepteve bazë /rezultatet e të nxënit / temat / kodin e etikës / orët në auditor leksion / seminar / format e kontrollit të dijës / frekuentimin / literaturën. Silabuset janë formuluar në shqip dhe anglisht dhe janë në përputhje me udhëzimet.</p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor I programit</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 9</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në Planin Mësimor të programit MSHM evidentohet që lëndët janë organizuar me një ngarkesë 3/2 ku 3 orë në javë janë leksion dhe 2 orë seminare/javë.</p> <p>Vitin e parë janë gjithsej 1500 orë;</p> <p>660 orë në auditor;</p> <p>840 orë për punë individuale;</p> <p>Vitin e dytë janë gjithsej 1550 orë;</p> <p>550 orë në auditor;</p> <p>1000 orë jashtë auditorit;</p>


	<p>Në vitin e dytë për shkak të ngarkesës së praktikës dhe punimi të diplomës, orët në auditor janë më pak. <i>Në totalin e orëve të ngrakesës ndonëse shkruhet 3000, në fakt po të bësh mbledhjen e elementëve është 3050 orë.</i></p> <p>Struktura e çdo lënde përmban leksione/seminare/detyrë kursi. Kontrolli i njohurive bëhet përmes kolokiumit/provimit përfundimtar/detyrës dhe angazhimit në seminare,</p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve në lidhje me kriteret specifike dhe të përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit bëhet përmes një tërësie dokumentacioni që përmban: Rregulloren e UNEL; Rregullorën e Fakultetit Ekonomik dhe Rregulloren e Departamentit. Drejtuesi i Departamentit u shpreh që është në komunikim të vijueshëm me studentët.</p> <p><i>Dokumenti 1.4: Rregullorja UNEL</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja e Fakultetit Ekonomik</i></p> <p><i>Dokumenti 1.15: Rregullorja e Departamentit të Administrimit Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit në MSHM synon të krijojë një formim dhe aftësim në fushat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - menaxhimi strategjik i avancuar; - menaxhim operacionesh dhe strategji operacionesh; - menaxhim strategjik i burimeve njerëzore dhe menaxhim shpërblimi; - menaxhimi i projekteve dhe kontratave; - qeverisje korporatash dhe biznes ndërkombëtar; - Menaxhim i riskut dhe sigurime; - Administrim Publik dhe Ekonomiks Menaxherial, etj <p><i>Në takimin në institucion, sugjeruam që programi ka nevojë për një lloj përditësimi dhe zhvillimi duke reflektuar transformimin digjital, inovacionin, marketingun etj.</i></p>

	<p>Nga pikëpamja e formatit të silabuseve është në përputhje me VKM 41 të vitit 2018.</p> <p>Në lidhje me silabuset e lëndëve duhet <i>evidentuar që nga pikëpamja e literaturës bazë, në një pjesë të silabuseve konsiderohen leksionet e përgatitura nga pedagogu, tekste në shqip, referimi i literaturës është në pjesën më të madhe i paplotë (mund t'i referohen sistemit APA).</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që sylabuset të përmirësohen, të përditësohen dhe literatura të rifreskohet.</i></p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 9</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>								
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, vlerësuesit theksuan nevojën që Studimi i Tregut të Punës duhet të ishte fokusuar mbi programin e studimit, në përdorimin e pyetësorëve, fokus grupeve, takimeve periodike me studentët, takimeve me alumnit, tregun e punës, etj. <u>Programi ka nevojë të përditësohet dhe zhvillohet, gjithçka ka ndryshuar në kontekstin e afërt dhe të largët.</u></i></p> <p><i>Evidence 5.19: Studimi i tregut të punës</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë” ka hapësira për përmirësime, përditësime dhe zhvillime</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="534 1456 742 1556">Në përmbushje</th> <th data-bbox="742 1456 933 1556">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="933 1456 1141 1556">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1141 1456 1372 1556">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar Planit Mësimor të programit MSHM lëndët janë me 5. 6 ose 7 ECTS organizuar me një ngarkesë javore 3orë leksion/2 orë seminare.</p> <p>Semestrat kanë nga 30 ECTS dhe në semestrin e dytë të vitit të dytë është përqëndruar praktika dhe punimi i diplomës.</p> <p>Programi i studimit në MSHM synon të krijojë një formim dhe aftësim në fushat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - menaxhimi strategjik i avancuar; - menaxhim operacionesh dhe strategji operacionesh; - menaxhim strategjik i burimeve njerëzore dhe menaxhim shpërblimi; - menaxhimi i projekteve dhe kontratave; - qeverisje korporatash dhe biznes ndërkombëtar; - menaxhim i riskut dhe sigurime; - administrim publik dhe ekonomiks menaxherial, etj
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p><i>Vlerësuesit e jashtëm gjatë takimit në institucion u dakordësuan me stafin e departamentit për nevojën e një dinamike në programin MSHM, që jo vetëm të reflektojë ndryshimet agresive në tregun lokal të punës, por dhe më gjerë në tregun global. Lëndë si Menaxhimi inovacionit, Menaxhimi i sistemeve të informacionit apo Marketingu digjital duhen përfshirë, ndërkohë që mund të rishihen përsëritjet BA-MSH dhe apo lëndë të përafërta në program.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program</p>	<p><i>GJV sugjeron që departamenti të bëjë një studim më të strukturuar në tregun lokal dhe më gjerë, të përdorë fokus grupet me studentët, me alumnit dhe tregun e punës, si dhe programe të ngjashme në rajon dhe më gjerë për të parë dinamikat e tyre.</i></p> <p>Struktura e çdo lënde përmban leksione/seminare/detyrë kursi. Kontrolli i njohurive bëhet përmes kolokiumit/provimit përfundimtar/detyrës dhe angazhimit në seminare.</p>

<p>duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi MSHM është hartuar me lëndë dhe module (gjithsej - 120 ECTS,) në përputhje të plotë me systemin europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve, në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 41/viti 2018, dhe si i tillë i jep mundësinë studentëve të transferojnë studimet brenda dhe jashtë Shqipërisë</p> <p><i>Dokumenti 3.9: Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 9</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p> <p><i>Dokumenti 5.19: Studimi i tregut të punës për MSHM</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Formati i silabuseve është në përputhje të plotë me VKM Nr 41, të vitit 2018, silabuset janë në shqip dhe anglisht, por siç kemi theksuar dhe më lart në portalin e ASCAL-it janë ngarkuar në shqip silabuse të departamentit të marketingut dhe inxhinierisë, ndërkohë silabuset e ngarkuara në anglisht janë në përputhje të plotë nga pikëpjmja e elementëve të strukturës me VKM N. 41.</p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit MSHM, synon të formojë studentët me njohuri, aftësi dhe qëndrime të domosdoshme për tregun e punës lokal dhe më gjerë. Në silabuset e lëndëve shprehen qartë objektivat dhe rezultatet që lëndët/modulet synojnë të arrijnë dhe gjithë mënyra si ngrihen tematikat javë pas javë dhe si ndërtohen seminarët/ detyrat e kursit dhe rastet studimore është në shërbim të punësimit të tyre dhe angazhimit në tregun e punës dhe për nivelin e tretë të studimeve.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 9</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>

prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.									
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës” plotësohen kriteret</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Në RVB gjejmë të shprehur se departamenti organizon në fund të vitit akademik mbledhje në të cilën analizon përmbajtjen e programit MSHM, por si në raport ashtu dhe në tërësinë e dokumentave të paraqitura në portalin e ASCAL -it nuk gjejmë gjurmë të këtyre mbledhjeve.</p> <p><i>Sugjerimi i vlerësuesve të jashtëm për Departamentin e AB të FE-UE, është që krahas diskutimit në Departament, të zhvillojë pyetësorë me studentët që e ndjekin programin, takime periodike me studentët, tregun e punës dhe alumni, t'i dokumentojë takimet dhe rezultatet.</i></p> <p>Raporti i Analizës Vjetore të Departamentit, duhet vlerësuar, por duhet theksuar që nuk prek çështje përmbajtësore të programit dhe të silabuseve të MSHM. Gjithashtu, siç kemi theksuar dhe më lart “Studimi i tregut të punës” nuk kontribuon në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së programit MSHM.</p> <p><i>Dokumenti 5.19: Studimi i tregut të punës</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB,</i></p> <p><i>Dokumenti 1.24: Analiza vjetore e departamentit të administrim-biznesit 2021-2022</i></p>

(Kok)

[Signature]

<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik, ata theksuan qasjen shumë positive që kanë në ndërveprimin me studentët. Plotësimi i kriterëve të standardit kërkon që krahas qasjes institucionale për të matur përmes pyetësoreve cilësinë e veprimtarisë akademike dhe administrative të universitetit në përgjithësi, <i>duhet të ndërtohet një metodologji dhe procedurë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies së çdo pedagogu të departamentit dhe të detajohet pyetësi në funksion të lëndëve dhe pedagogëve. Shumë e rëndësishme është që veprimtari të që bëhen të dokumentohen.</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB</i></p> <p><i>Dokumenti 5.20: Drejtoria Juridike, Karrierës dhe Alumni</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Në takimin me stafin e Departamentit, u theksua që një vlerë e shtuar për programin në përmirësimin e tij ka prezencën në mësimdhënie e disa pedagogëve që vijnë nga FEUT, referenca e një pjese të programit në përvojën e programeve të FEUT, mundësia që pedagogët kanë përmes shkembimeve Erasmus dhe projekteve ndërkombëtare.</p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 6</i></p> <p><i>Dokumenti 3.2: Të dhëna mbi mobilitetin e personelit të FEUE</i></p> <p><i>Dokumenti 3.1: Lista e marrëveshjeve Erasmus</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre" Departamenti dhe Fakulteti duhet të projektojë dhe dokumentojë një sërë veprimtarish.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm gjendet e shprehur që prioritetet dhe objektivat kryesore të programit MSHM paraqiten në Strategjinë e Zhvillimit të Programit të Studimit – <i>por një dokument i tillë nuk është arkivuar në platformën e ASCAL-it.</i></p> <p>Strategjia e Zhvillimit të Departamentit, mbulon disa elementë të këtij kriteri, por si <i>dokument i hartuar nuk i referohet një periudhe kohore të caktuar. Gjithashtu, duhet hartuar Rregullorja e Programit të Studimit MSHM, në përputhje me Rregulloret e FE dhe UE dhe aty të shprehen prioritetet dhe objektivat e programit.</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB</i></p> <p><i>Dokumenti 1.3.: Strategjia UE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.18: Strategjia e Zhvillimit të Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Bazuar në <i>Nenin 27 dhe 28 të Rregullores së UE</i> përcaktohen detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore në raport me administrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe të kërkimit.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik përmes një tërësie kapitujsh paraqiten dispozitat e përgjithshme, programet e studimit, elementet e programeve të studimit, elementët e kontrollit të dijës, etj. Në Rregulloren e Departamentit, në <i>nenin 1</i> pasqyrohet “Organizimi i departamentit të Administrim-Biznesit”; në <i>nenin 2</i> :Funksionet e Departamentit në bashkërendimin e të gjitha veprimtarive mësimore dhe shkencore”, në <i>Nenin 3</i> -kompetencat e drejtuesit të departamentit dhe kompetencat e drejtuesit të gruplëndëve.</p> <p>Rregulloret në nivel Universiteti dhe Fakulteti janë në përputhje të plotë me dokumentat kryesore të MAS, veçanërisht ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015.</p> <p><u><i>Rregullorja Departamentit duhet të sistemohet, të paktën nga ana formale.</i></u></p> <p><i>Dokumenti 1.4: Rregullorja e Universitetit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja e Fakultetit Ekonomik</i></p> <p><i>Dokumenti 1.15: Rregullorja e Departamentit të Administrim Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit</p>	<p>Departamenti nxit studentët për t’u bërë pjesë e aktiviteteve të ndryshme, që nga lektorët e ftuar në auditor, thirrjet për</p>

dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	shkëmbimet Erasmus, angazhimin në projekte ndërkombëtare, pjesëmarrjen në konferencat e Fakultetit dhe punimet e përbashkta me pedagogët në Buletinin e universitetit. Në RVB, tabela 22 ka një statistikë të thjeshtë të angazhimit të studentëve në punën shkencore, por që <i>duhej pasuruar dhe detajuar.</i> <i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 22</i>
--	--

Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Universiteti mbështet pedagogët me pjesëmarrjen çdo vit në Konferencën Ndërkombëtare dhe botimin në Buletinin Shkencor të UE. Gjatë takimit në institucion pedagogët u shprehën të kënaqur me angazhimin e tyre në projektet COST, Erasmus exchange, Erasmus capacity building, etj. Gjithashtu, anëtarë të departamentit ishin fitues të thirrjeve të AKSHI-t. Gjithashtu pedagogët u shprehën se një nga anëtarët e departamentit ishte mbështetur nga fondi universitetit për projektet e kërkimit. <i>Dokumenti 2.5: Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i> <i>Dokumenti 3.11. të dhëna të plota mbi kërkimin shkencor të stafit</i> <i>Dokumenti 3.1: lista e marrëveshjeve Erasmus</i>
---	---

Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor” departamenti ka hapësirë për të formalizuar një pjesë të dokumentacionit bazë, dhe të gjithë angazhimit të studentëve në aktivitetet.</i>
--------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin	Gjatë takimit në Departamentin e Administrim – Biznesit, evidentuam disa anë pozitive të plotësimi të kriterëve që lidhen me këtë standard.

<p>me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Anëtarët e departamentit kishin një qasje proaktive ndaj thirrjeve për projekte kërkimore të AKSHI-t dhe rezultate në këtë drejtim; - qasje proaktive në thirrjet e publikuara për shkëmbimet Erasmus exchange; - qasje proaktive në thirrjet e projektit COST – të cilat kanë natyrë kërkimi dhe të japin mundësi të punosh me rrjete akademikësh të fokusuar në subjekte kërkimi innovative;
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -bashkëpunim pozitiv me Buletinin e Universitetit, që jo vetëm ruan periodicitetin e botimit, por dhe që përban të gjitha fazat e botimit në një revistë shkencore; - pjesëmarrjen në konferencën vjetore të universitetit, në të cilën pedagogët angazhojnë dhe studentë; -organizimi i një sërë aktiviteteve me të ftuar nga biznesi/institucionet me studentët përmes Këshillit të Biznesit, strukturë e ngritur në nivel universiteti, por dhe përmes thirrjeve personale nga pedagogët;
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Ndonëse në RVB ka disa referenca në dokumenta të vendosura në portalin e ASCAL-it, në dy prej tyre jepen disa tabela përmbledhëse, shumë përgjithësuese që nuk diferencojnë njësitë kryesore/bazë dhe në nivel universiteti.</p> <p>GVJ gjykon se ato janë shumë të përgjithshme, nuk janë as në formatin e deklarimeve që universitetet bëjnë çdo vit, <u><i>në këto kushte sugjerojmë që Departamenti duhet të ketë një statistikë vjetore më të detajuar të punës shkencore dhe të veprimtarive të cituara më lart.</i></u></p> <p><i>Dokumenti 2.5: Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 3.11. të dhëna të plota mbi kërkimin shkencor të stafit</i></p> <p><i>Dokumenti 3.1: lista e marrëveshjeve Erasmus</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Në RVB referenca për këtë kriter bëhet në “Strategjinë e Departamentit të Administrim- Biznesit”, por <u><i>vlerësojmë që Studimi i duhur mbi Tregun e Punës, fokus grupet me studentët që vazhdojnë studimet, këshillimi me aktorë të tregut të punës, gjurmimi i studentëve që diplomohen, etj do të ishin testimi më efikas i suksesit të programit dhe i konkurrueshmërisë së tij.</i></u></p>

	<p>Në kushtet e një tregu të vogël, dhe të afërsisë me Tiranën, programi duhet të ketë ose një specifike lokale të fortë ose një dinamike dhe qasje që mund ta bënte konkurrent të fortë në tregun e arsimit të lartë. Kjo besojmë mbetet një sfidë e fortë për departamentin dhe fakultetin.</p> <p><i>Dokumenti 1.18: Strategjia e zhvillimit të departamentit të AB</i> <i>Dokumenti 3: RVB</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	N/A			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	N/A			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin "Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor" departamenti duhet të përmirësohet si nga pikëpamja strategjike, ashtu dhe nga pikëpamja formale e dokumentit të veprimtarive</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit shihet se procesi i mësimdhënies dhe mësim nxënies harmonizon format tradicionale si leksionet, seminarët, apo detyrat e kursit, me projekte dhe praktikat profesionale duke mbajtur parasysh ngarkesën në orët mësimore të punës individuale dhe orëve në auditor. Për tematika specifike me interes për studentët dhe transmetimin e dijeve organizohen edhe leksione të hapura me ekspertë vendas apo të huaj duke shfrytëzuar edhe platformat teknologjike. Nga takimi me pedagogë të angazhuar në programin e studimit MSHM, u evidentua pjesëmarrja e përfaqësuesve të biznesit në Qarkun e Elbasanit në leksione të hapura e nxitur kjo edhe nga shefi I departamentit i cili ka qënë pjesë e atij sektori.</p> <p><i>Dokumenti 3.10 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset në shqip dhe anglisht) Master I Shkencave në Menaxhim</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik përpiqet që të përzgjedhë format më efektive të mësimdhënies duke patur parasysh orën e mësimin, karakteristikat e lëndës, numrin dhe nivelin e mësimnxënies së studenteve, literaturën në dispozicion, si edhe kombinimin e aspektit teorik me atë praktik.</p> <p><i>Dokumenti 3.9 Plani mësimor i programit të studimit "Master i shkencave në menaxhim"</i></p>

(Keh)

Jg

	<p><i>Dokumenti 3.10 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset në shqip dhe anglisht) Master i Shkencave në Menaxhim</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UE mbështet personelin akademik në procesin e përmirësimit të mësimdhënies duke mundësuar përdorimin e mjeteve didaktike më të përshtatshme për tematikën e trajtuar përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe trajnimet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, ndonëse vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p>Shkolla Normale e Elbasanit e themeluar në vitin 1909, po kështu Instituti i Lartë Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani” janë themelet e ndërtimit të Fakultetit Ekonomik. Kjo traditë në përgatitjen e mësuesve të profileve të ndryshme është në ADN UE dhe gjykojmë që kjo traditë duhet të riaktivizohet jo vetëm në shërbim të stafit të angazhuar në njësinë bazë dhe kryesore të programit të studimit nën shqyrtim por edhe më gjerë. Ky element vecantë me universitetet e tjera mund ta ndihmojë për rritur konkurrueshmërinë e programeve të studimit në të ardhmen.</p> <p><i>Dokumenti 1.17 Strategjia e FE.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të Administrim-Biznesit</i></p> <p><i>Vëzhgimi i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit MSHM, ka përvojën e duhur profesionale dhe akademike në shpjegimin/transmetimin e njohurive dhe koncepteve të cilat ofrohen nga ky program. Numri i PAE për vitin 2020-2021 është 7 vetë. Nga të cilët, 3 mbajnë titullin Profesor i Asociuar, 3 mbajnë titullin Doktor shkencash dhe 1 Profesor doktor. Ndërkohë procesi i mësimdhënies ndihmohet edhe nga 12 pedagogë PAK të cilët kanë kualifikimin e duhur për tu angazhuar në mësimdhënie. Angazhimi i stafit të jashtëm në sektorin e biznesit është një plus për kontekstualizimin e kompetencave që ofron programi i studimit me raste konkrete nga tregu i punës.</p>

<p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin e departamentit dhe atë të angazhuar në programin e studimit u vu re që kualifikimet dhe eksperiencia e përfituar brenda dhe jashtë institucionit, trajnimet e ndryshme dhe publikimet mund të rriten më tej duke qënë se IAL ka një qasje shumë proaktive ndaj pjesëmarrjes në mobilite Erasmus, projekte si dhe konferenca ndërkombëtar të organizuara nga vet UE.</p> <p><i>Dokumenti 4.17 CV e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit "Master i shkencave në menaxhim"</i></p> <p><i>Dokumenti 4.18 Plani i ngarkesës mësimore për vitin akademik 2021-2022 të Departamentit të Administrim-Biznesit</i></p> <p><i>Dokumenti 1.24 Analiza vjetore e departamentit të administrim-biznesit 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>UE ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë qëllim shërben pyetësori i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatit e tyre. Në dokumentin 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022 paraqitet baza ligjore për këtë proces, metodologjia, fushat e vlerësimit nga ana e studentit, rezultatet përkatëse per FE. Megjithatë nuk është plotësisht e qartë se si rezultatet integrohen në procesin e përmirësimit të programit të studimit po kështu edhe studentët nuk janë plotësisht të qartë se si integrohen këto rezultate në kurrikulat e programit(nga takimi i GVJ me studentët që ndjekin programin e studimit MSHM). Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga ana e NJSBC-së me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen. Vlen të theksohet se struktura e kontrollit/përmirësimit të cilësisë funksionon më shumë në nivel institucioni se në nivelin e FE dhe është një strukturë relativisht e re. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë strukturë në nivel institucional u vu re dëshira dhe proaktiviteti për t'u pajisur me praktika dhe përmirësimin e vazhduar të tyre. <u>GVJ rekomandon që studentët të përfshihen më shumë në këtë proces, jo vetëm duke i bërë pjesë si detyrim institucional por edhe duke i informuar për rëndësinë e këtij procesi.</u></p> <p><i>Dokumenti 1.1 Statuti i UNIEL, Kapitulli X, Neni 71</i></p>





	<p><i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p> <p><i>Dokumenti 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel instiucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UE ofron një kornizë instiucionale mbështetëse për njësinë kryesore, njësinë bazë dhe më tej për programin e studimit. Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë është e përbërë nga tre sektorë, Sektori i Koordinimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe LLL Centre(qëndra për të mësuarit gjatë gjithë jetës). Të tre këto sektorë bëjnë të mundur integrimin e pedagogëve në mobilitete, projekte etj.</p> <p>Ndërkohë, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë koordinon të gjitha proceset që i dikton ligji në lidhje me njësitë dhe më veçanërisht për programet e studimit.</p> <p>Për periudhën 2020-2022, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe ai Koordinimit kanë përfshirë studentët në një sërë trajnimesh për tematike relevante për kohën si: 1.Si të luftojmë dezinformimin, 2.Integrimi i studentëve në tregun e punës, 3.Projekti përtej gardheve, 4.Seancë trajnimi me profesorë të Humboldt Berlin,5.Validimi i kompetencave në fushën e marketingut të shërbimeve dhe sjelljes konsumatore etj. GVJ i vlerëson si nisma positive për përmirësimin e aftësive jo vetëm të studentëve por edhe të pedagogëve.</p> <p><i>Dokumenti 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 1.12 Analiza vjetore instiucionale 2020-2021</i></p> <p><i>Dokumenti 1.10 Lista e trajnimit të studentëve</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që ky standart përmbushet plotësisht dhe pse gjykon që duhet bërë më shumë në të ardhmen për të aktivizuar proceset e mësimin të vazhduar si një pikë e fortë dhe traditë e UE.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kontrolli i dijeve dhe përvetësimit të objektivave të programit dhe kompetencave profesionale të parashikuara bëhet nepërmjet harmonizimit të disa komponentëve si për shembull testimet e vazhdueshme me shkrim dhe me gojë, prezantimet e projekteve dhe detyrave të kursit, praktikave të përfshira në programin e kursit, frekuentimit dhe diskutimeve në auditor, por edhe provimeve me shkrim, etj. Të gjitha këto forma përcaktohen në rregulloren e programit të studimeve ku përfshihen edhe mënyra e kontrollit të dijeve në për lëndët përkatëse. Studentët njoftohen mbi këtë rregullore gjatë javës së (parë të fillimit të studimeve) orientimit, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Rregullorja dhe afatet e përcaktuara në kalendarin akademik bëhen publike dhe mund të konsultohen online. Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës i programit të studimit vihet në dispozicion të studentëve edhe Manuali (<i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i>) përkatës i përgatitur nga institucioni.</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3.9 Plani mësimor i programit të studimit "Master i shkencave në menaxhim"</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të lëndës në çdo semestër, titullari i lëndës i njeh studentët me silabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar emërimi dhe kreditet e lëndës, pedagogu i lëndës, vit/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin e studentit, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë tij, literatura e detyruar, si edhe mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Kështu praktika e ndjekur nga disa prej moduleve të MSHM, sa i përket llojeve të vlerësimit shihet një shpërndarje e mirë përgjatë gjithë vitit për të nxitur angazhimin e studentit, (për shembull në lëndën Menaxhim Projekti, 10% e notës përbëhet nga assignment apo detyra klase, 20% kolekiume, 20% raste studimore dhe 50% provimi final).</p>

	<p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3.9 Plani mësimor i programit të studimit "Master i shkencave në menaxhim"</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Ashtu si u përmend edhe më sipër në UE bëhet një vlerësim i vazhdueshëm i njohurive në të gjitha lëndët, duke analizuar performancën e studentit në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe në funksion të arritjes së objektivave të programit. Kështu në manualin e punimit të temës së diplomës paraqitet guida e punimit nga konceptimi te punimi final (pika 2.3), kriteret e vlerësimit të temës së diplomës së masterit, përmbajtja e projekt-propozimit, struktura e punimit shkencor, etika në kërkim, citimet dhe plagjiatura etj.</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që UE dhe njësia përgjegjëse për programin e studimit disponon të gjithë elementët institucionalë për të testuar dhe vlerësuar njohuritë si dhe të demonstrojnë njohuritë e fituara nga studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi III.3</p> <p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje (0-100%) e notës përfundimtare. Niveli i të nxënit vlerësohet përmes detyrave me shkrim dhe /ose me gojë duke përfshirë</p>

<p>akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulet.</p>	<p>angazhimin në diskutime, detyra kursi të përgatitura gjatë seancave mësimore (10%-30% e vlerësimit), detyrat e kursit (0-20%) si dhe provimit të ndërmjetëm (10%-40% e vlerësimit) dhe atij përfundimtar (50% e vlerësimit).</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në vlerësimin e njohurive të lëndës do të përdoren së shpejti sisteme elektronike për kontrollin e provimeve. UE zbaton prej dy vitesh sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve në sajë të projektit Cleanscore të financuar nga AADF. Gjithashtu pandemia e pajisi institucionin me një praktikë të mirë sa i takon shkëmbimit të vazhduar me studentin nëpërmjet paketës elektronike Microsoft Teams. Kjo e fundit u përdor për vlerësimin e vazhduar gjatë seminareve, zhvillimin e kuiceve etj. Ndërkohë në sistemin elektronik të UE-së hidhet rezultati përfundimtar dhe studentët informohen në kohë reale për notën e tyre duke rritur në këtë mënyrë transparencën.</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p> <p><i>Dokumenti 3.4 Marrëveshja për implementimin e CleanScore</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi studimit bëhet në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UNIEL dhe asaj të FE. Pedagogu vlerëson me pikë secilin komponent të parashikuar në syllabus. Në rregulloren e FE në kreun e pestë paraqiten në mënyrë të detajuar, <i>Neni 35-45 kontrolli i dijeve dhe vlerësimi</i>. Në të paraqiten gjithashtu: Format e kontrollit të dijeve, sistemi i vlerësimit, afatet e provimeve, kushtet për hyrjen në provim, mënyra e zhvillimi të provimit, dokumentimi i sistemit të vlerësimit, proceset ankimese, riprovimet si dhe mbartjet për vitin pasues.</p> <p><i>Dokumenti 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>

<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregulloret e UE parashikojnë vlerësim të detajuar për çdo pyetje dhe sqarime dhe argumentime për vlerësimin e marrë nga studenti për çdo detyrim të lëndës. Gjithashtu, vlerësimi i studentëve ka natyrë stimuluese dhe duhet të tregojë se çfarë di studenti dhe çfarë duhet të mësojë më shumë. Për këtë arsye vlerësimi i pedagogut mund të shoqërohet me konkluzime. Gjithashtu kontrolli i vazhduar nëpërmjet seminareve, detyrave të kursit, apo ëorkshopeve janë një mënyrë e shkëmbimit të vazhduar pedagog-student dhe e anasjella.</p> <p><i>Dokumenti 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të provimeve, ambjenti monitorohet nga dy pedagogë të caktuar nga Departamenti, ndërsa kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese. Plagjiatura, tentativat për mashtrim apo cënim të rregullave gjatë procesit akademik sqarohen edhe në Manualin për Përgatitjen e Temës së diplomës ku studentët njihen me integritetin akademik si dhe etikën në kërkim. Studentëve u bëhet e qartë rëndësia e origjinaliteti të punimit, citimi i burimeve si duhet etj.</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UE dhe asaj të FE. Pedagogu vlerëson me pikë secilin komponent të tezës. Rezultatet e vlerësimeve të provimeve bëhen në përfundim të provimit brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tyre nota hidhet në sistemin EMS ku çdo student ka një account. Sistemi EMS gjeneron automatikisht procesverbalin i cili përmban komisionin e provimit. Ky procesverbal firmoset nga komisioni i provimit dhe dorëzohet në sekretari ku firmosen nga kryesekretarja dhe më pas dekani. Vlerësimi për komponentët e tjerë i dorëzohet studentit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. <i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti ka të drejtë që të ankohet për rregullat e zhvillimit të provimit brenda 24-orëve nga data e provimit dhe ankesa i paraqitet me shkrim pergjegjësit të departamentit, i cili nëse verifikon shkelje të korigjueshme ndërmerr hapat e nevojshëm së bashku me komisionin e provimit. Në rast se shkeljet nuk janë të korigjueshme atëherë vendimi i përcillet dekanit që nëse e shikon me vend merr vendim për anulimin e provimit dhe rishillimin e tij.</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i></p>								
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rast se studenti nuk është i bindur për vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut, atëherë ankohet me shkrim pranë përgjegjësit të departamentit dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e problemit e përcjell tek dekani. Dekani pasi vihet në për ankesën ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.</p> <p><i>Dokumenti 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL</i> <i>Dokumenti 1.7 Rregullore e studimeve FE</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që UE disponon kornizën e duhur për vlerësimin e duhur të studentit si dhe marrjen e feedback të vazhduar nga ana e tyre në lidhje me kompetencat që ata do të pajisen dhe vlerësimin për to.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="558 1377 758 1489">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="758 1377 949 1489">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="949 1377 1149 1489">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1149 1377 1375 1489">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="558 1489 758 1550"></td> <td data-bbox="758 1489 949 1550"></td> <td data-bbox="949 1489 1149 1550"></td> <td data-bbox="1149 1489 1375 1550" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë</p>	<p>Programi i studimit MSHM ofruar nga Departamenti i Administrim Biznesi në FE-UE, synon që të pajisë studentin me</p>

<p>thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>njohuritë e nevojshme si në profilin akademik ashtu edhe profesional. Programi ofron njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit, duke harmonizuar aspektin teorik me metodologji e lëndë aplikative që plotësojnë orientimin e moduleve të programit në fushën e ekspertizës së programit.</p> <p><i>Dokumenti 3.9 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në menaxhim”</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Nëpërmjet lëndëve të ofruara nga programi i studimit MSHM, synohet zhvillimi i aftësive të veçanta në fushëm e menaxhimit. Lëndë si Menaxhim Operacional, Menaxhim Strategjik, Ekonomiks Menaxherial, Aftësi menaxheriale, ndërthuren me aftësi të veçanta në drejtim të aspekteve njerëzore në një organizatë si Menaxhim Strategjik i Burimeve Njerëzore, Menaxhim Shpërblymje etj. Mënyra se si është hartuar programi i studimit dhe modulet që bëjnë pjesë në të aftësojnë studentë që mund të punësohen në sektorin privat por edhe atë publik. Po kështu lëndë si “Metoda Kërkimi” shërben për kërkim të aplikuar në detyrat e kursit në lëndë të ndryshme.</p> <p><u><i>Megjithatë pavarësisht moduleve të përfshira në këtë program studimi, IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të argumentuar metodologjinë në përzgjedhjen e lëndëve. Si është përmendur dhe më lart, raporti i kërkimit të tregut nuk i evidenton ato. Po kështu IAL duhet të ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme një proces benchmark-u për ndërtimin e programit jo vetëm duke u bazuar në IAL-të në vend por edhe në universitete të huaja. Kjo do të rrisë cilësinë e programit, ndërkombëtarizimin dhe do të ndihmojë në përditësimin e vazhduar të tij.</i></u></p> <p><i>Dokumenti 3.9 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në menaxhim”</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo</p>	<p>Si rregull, në përfundimit të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim.</p>

<p>lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Gjithashtu detyra e kursit dhe kolekiomet që zhvillohen gjatë vitit janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda.</p> <p><i>Dokumenti 3.9 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në menaxhim”</i></p> <p><i>Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p> <p><i>Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi harmonizon njohuritë teorike me aspektin praktike, përmes projekteve tematike apo detyrave të kursit ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra.</p> <p>Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila nën mbikqyret nga një pedagog i departamentit ndihmon në rritjen e aftësive profesionale dhe mundësi më të mira për integrimin në tregun e punës.</p> <p>Nga takimi me pedagogët e Departamentit të Administrim Biznesit u vu re pjesëmarrja aktive e stafit të angazhuar në programin e studimit MSHM. Pjesëmarrja në projekte Erasmus + si Entrepreneurial Skills for a Modern Education si dhe Projekti VIVA për ngritje kapacitetesh(Enhancing and Validating Service Related Competences in Versatile Learning Environment in Eastern Balkan Universities) i jep mundësinë stafit pedagogjik të përballët me rëndësinë e konceptimit të kurrikulave nga nevojat e tregut.</p> <p><i>Dokumenti 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i></p> <p><i>Dokumenti 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit, neni 12</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor me lektorë apo ekspertë të ftuar me qëllim që të informoje kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Si u përmend dhe me siper institucioni përdor kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, por edhe trajnime apo leksione të hapura. Për periudhën 2020-2022, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe ai Koordinimit kanë përfshirë studentët në një sërë trajnimesh për tematika që nuk lidhen vetëm me programin e studimit që ata ndjekin por edhe me gjerë për formimin e tyre.</p>

	<p>Përmendim trajnimet si vijon: 1.Si të luftojmë dezinformimin, 2.Integrimi i studentëve në tregun e punës, 3.Projekti përtej gardheve, 4.Seancë trajnimi me profesorë të Humboldt Berlin,5.Validimi i kompetencave në fushën e marketingut të shërbimeve dhe sjelljes konsumatore etj. GVJ e vlerëson si praktikë positive për përmirësimin e aftësive jo vetëm të studentëve por edhe të pedagogëve.</p> <p><i>Dokumenti 1.10 Lista e trajnimit të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Për të nxitur një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve novative, stafi akademik organizon orë të hapura me përfaqësues të biznesit në zonën e Elbasanit dhe nxit studentët të marrin pjesë në konferenca shkencore. Kjo e fundit realizohet në kuadër të Buletini Shkencor i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për përparimin e shkencës. Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të gjetjeve shkencore të akademikëve shqiptarë brenda dhe jashtë mjedisit universitar shqiptar. Rëndësia e botimit të Buletinit qëndron në dhënie e mundësisë për të gjithë kërkuesit akademikë, të cilët sjellin gjetjet më të reja në fushat përkatëse të tyre si dhe përditësojnë në kohë gjetje të mëparshme.</p> <p>Megjithëse në informacionin e dokumentuar nga UE për aktivitetin shkencor në kuadër të Buletinit Shkencor përmenden edhe studentët, nuk detajohen punimet e tyre (Dokumenti 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL). Në këto kushte <u>GVJ rekomandon që të specifikohet përfshirja e studentëve si dhe ëeb në lidhje me këtë aspekt të komunikojë përfshirjen e studentëve.</u></p> <p><i>Dokumenti 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL</i></p> <p>https://www.uniel.edu.al/kerkimi-shkencor/buletini-shkencor/publikime-ne-vite</p> <p><i>Dokumenti 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që programi i studimit bën përpjekje për të garantuar rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët dhe ky proces ndihmohet edhe nga pjesëmarrja e pedagogëve të angazhuar në këtë program</i></p>

	<i>studimi në projekte që lidhen pikërisht me kompetencat dhe validimin e tyre në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit përfundon me mbrojtjen e temës së diplomës një provim publik përpara një komisioni, i cili përbëhet nga dy pedagogë dhe ngrihet për këtë qëllim. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. Teza është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij. UE ka paraqitur në rregulloret si dhe në manualin e posaçëm (<i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i>) të gjithë elementët informues që i duhen një studentit para diplomimit. Në manual paraqiten të gjitha kriteret e përmbajtjes dhe strukturës që një student duhet të ndjekë në punimin e mikrotezës.</p> <p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Studenti udhëhiqet gjatë periudhës së përgatitjes së tezës nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit. Për përgatitjen e tezës studentit i ofrohet edhe një ndihmë e specializuar nëpërmjet një udhëzuesi, i cili ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat dhe hapat që duhen ndjekur nga studentët për zhvillimin e tezës. Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera me pedagogun udhëheqës. Si u përmend edhe më sipër IAL ka një praktikë të përcaktuar qartë sa i përket procedurave të propozimit të temës së diplomës si edhe përgjegjësitë e studentit diplomant dhe pedagogut udhëheqës.</p>

	<p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit,</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i departamentit i profilizuar në fushën përkatëse. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët në bazë të temave që paraqesin ata ose pedagogët e programit. Mentorimi i studentit bëhet nga udhëheqësi i tezës i miratuar nga departamenti në bazë të dispozitave në fuqi. Kërkesa për të propozuar temat dhe mentorin bëhet pranë kordinatorit të programit i cili harmonizon kërkesat e studentëve me mundësitë reale pa cënuar cilësinë e punimeve të diplomave dhe duke evituar përsëritjet.</p> <p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Takimi me stafin</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në përgatitjen e temës së diplomës studentët ndihmohen nga stafi i programit për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, hedhjen e të dhënave grafike apo statistikore, përpunimin e pyetësorëve apo anketave duke përdorur të gjithë infrastrukturën e bibliotekave, sallave të kompjuterave por edhe duke shfrytëzuar bazën kërkimore apo arshivore të institucioneve të tjera me të cilat programi ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Takimi me stafin e departamentit të AB</i> <i>Vizita ne IAL, sallat e kompjuterave</i></p>

<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos komisioni i ngritur për këtë qëllim. Kriteret e vlerësimit janë: cilësia e shkrimit, organizimi, stili, parashtrimi dhe zhvillimi i ideve. Në seksionet 2.4.1-2.4.8 të <i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i> paraqiten të detajuar këto elementë.</p> <p>Sezonet e rregullta të mbrojtjes së diplomës janë ato të verës, vjeshtës dhe dimrit ndërsa sezone specifike mund të përcaktohen me urdhër të drejtorit të Dekanit. Anëtarët e komisionit (3-5 anëtarë, jo më pak se 5, të propozuar nga përgjegjësi i departamentit dhe miratuar nga dekani) bien dakord për notën dhe në rast se kjo nuk arrihet vendoset mesatarja e notave të propozuara nga të gjithë anëtarët.</p> <p><i>Dokumenti 3.5 Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit neni 62-63</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave në “Menaxhim” dhe suplementin e saj, sipas formatit të miratur nga MASR dhe i firmosur nga Dekani i FE dhe Rektori i UE.</p> <p><i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit neni 61-63</i> <i>Dokumenti 3.7 Formatit i punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)</i> <i>Dokumenti 3.8 Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit “Master i shkencave në menaxhim”</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Pas përfundimit të studimeve, kopje e dokumentacionit të studentit të regjistruar arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje me detyrimet institucionale, informacioni i paraqitet palëve të interesuara në përputhje me normativat ligjore për ruajtjen e të dhënave personale. (<i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit neni 61-63</i>)</p> <p>Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse apo nevojave të vetë institucionit.</p> <p><i>Dokumenti 1.7 Rregullore e Fakultetit neni 61-63</i> <i>Takim me specialistë të sekretarisë mësimore të FE-UE</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në	NA

dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.									
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që programi i studimit bën përpjekje për të garantuar rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët dhe ky proces ndihmohet edhe nga pjesëmarrja e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi në projekte që lidhen pikërisht me kompetencat dhe validimin e tyre në tregun e punës. Gjithashtu GVJ vlerëson që UE disponon kornizën e duhur për vlerësimin e duhur të studentit si dhe marrjen e feedback të vazhduar nga ana e tyre në lidhje me kompetencat që ata do të pajisen dhe vlerësimin për to.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të	Institucioni ka angazhuar staf akademik PAE dhe PAK për të plotësuar kërkesat e programit, të cilët kanë përgatitjen profesionale në fusha të ndryshme dhe të angazhuar në mësimdhënie të lëndëve që përputhen me fushat e tyre të kërkimit shkencor. Më konkretisht, në dy vitet e fundit janë

studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

angazhuar 10 pedagogë për zhvillimin e programit të studimit. Nga të cilët, 7 janë PAE dhe 3 PAK. Stafi plotëson kushtin ligjor të kualifikimit shkencor për t'u angazhuar në ciklin e dytë të studimeve. *Referuar Dokumenti RVB, Tabela , 6, GVJ* konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit është:

1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 3 PAK (70 % /30 %)
2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 3 PAK (70 % /30 %)
3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 3 PAK (70 % / 30 %):

Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	-	1	1	1	1	1
Prof.As.Dr	4	-	3	-	3	-
Dr/PhD	3	2	3	2	3	2
Msc	-	-	-	3	-	3
Në total	7	3	7	3	7	5

Në programin e studimit MSHM, stafi PAE mbulon 95% të ngarkesës.

Dokumentu RVB, Tabela , 6, 7, 12

Dokumentu 4.17 CV e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit "Master i shkencave në menaxhim".pdf

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Si u analizua edhe më sipër personeli akademik mbulon 95% të ngarkesës akademike në lidhje me programin e studimit MSHM duke siguruar qëndrueshmërinë e programit të studimit por nga ana tjetër, ngarkesa në orë mbi normën e parashikuar për stafin e angazhuar në këtë program studimi bën të vështirë angazhimin e stafit në aktivitete të tjera që lidhen me zhvillimin strategjik të programit të studimit në të ardhmen. IAL duhet të bëjë përpjekje

	<p>për ta përmirësuar këtë tregues sepse kjo ndikon në cilësinë e programit të ofruar.</p> <table border="1" data-bbox="558 291 1356 638"> <thead> <tr> <th></th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2019 - 2020</th> </tr> <tr> <th>Ngarkesa ne auditor</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td><u>1210</u> ore ne auditor</td> <td>60 ore</td> <td><u>1210</u> ore ne auditor</td> <td>60 ore</td> <td><u>1210</u> ore ne auditor</td> <td>60 ore</td> </tr> <tr> <td>Raporti ne %</td> <td><u>95%</u></td> <td>5%</td> <td><u>95%</u></td> <td>5%</td> <td><u>95%</u></td> <td>5%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Dokumenti RVB, Tabela , 12 Ngarkesa totale e stafit akademik të programit të studimit MSHM</i></p> <p><i>Tabela 12:Plani mesimor i lidhur me personelin akademik perkates</i></p>		2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020		Ngarkesa ne auditor	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:		<u>1210</u> ore ne auditor	60 ore	<u>1210</u> ore ne auditor	60 ore	<u>1210</u> ore ne auditor	60 ore	Raporti ne %	<u>95%</u>	5%	<u>95%</u>	5%	<u>95%</u>	5%
	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020																								
Ngarkesa ne auditor	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																							
	<u>1210</u> ore ne auditor	60 ore	<u>1210</u> ore ne auditor	60 ore	<u>1210</u> ore ne auditor	60 ore																							
Raporti ne %	<u>95%</u>	5%	<u>95%</u>	5%	<u>95%</u>	5%																							
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga intervistimi stafit të angazhuar në programin e studimit, të personelit të Degës së Burimeve njëzore por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u vu re qëndrueshmëria në vite e angazhimit të stafit si dhe procedurat institucionale për ta siguruar atë. Në zyrën e Burimeve njerëzore u konsultua dokumentacioni i stafit të angazhuar dhe nuk u vu re asnjë parregullsi sa i takon pajisjes me kontrata dhe mbulimet me sigurime shoqërore e shëndetësore. <i>(Dokumenti 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, neni 16).</i></p>																												
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UE në përputhje me aktet e veta rregullatore <i>(Dokumenti 1.1 Statuti i UNIEL, kreu 6, për punësimin e stafit, akademik PAE, PAK dhe administrative)</i> ka të përcaktuara procedurat e rekrutimit të personelit akademik, jo akademik si dhe personelit ndihmës akademik. Në bazë të dokumentacionit si edhe në vizitën që GVJ pati në institucion evidentohet e gjithë rruga dhe procedurat që ndiqen për punësimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik. Departamenti bën planifikimin për staf akademik bazuar në nevojën dhe mbingarkesën e stafit aktual, dhe kjo kërkesë kalohet për miratim tek Rektori i UE, pasi është miratuar nga Dekani i FE. Pasi kërkesa miratohet, nga Fakulteti ajo publikohet në faqen e internetit të institucionit. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një</p>																												

	<p>Komision ad-hoc, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, fakultetit dhe departamentit të gjithë me gradën “Profesor”.</p> <p><i>Dokumenti 1.1 Statuti i UNIEL, kreu 6, për punësimin e stafit, akademik PAE, PAK dhe administrativ</i></p> <p><i>Dokumenti 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik</i></p> <p><i>Dokumenti 4.4 Rregullore e rekrutimit të personelit administrativ</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UE angazhon staf ndihmës akademik për zhvillimin e laboratorëve por në rastin e programit të studimit MSHM, ndihmën ndaj studentëve për përpunimin e të dhënave të kërkimeve empirike në kuadër të punimeve të diplomës e ofronin pedagogët udhëheqes (takimi me stafin e angazhuar në programin e studimit MSHM).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UE në strukturën e saj ka edhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, në varësi të së cilës janë edhe Sektori i personelit dhe Sektori i Protokoll-Arkivës (<i>Dokumenti 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i>). Zyra e Burimeve njerëzore, mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë UE (<i>Dokumenti 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, neni 16</i>). Pra sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës funksionojnë në nivel IAL-je (<i>Dokumenti 1.11 Struktura organizative e UNIEL.pdf</i>).</p> <p>Nga intervistimi i personelit të Degës së Burimeve njerëzore por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë (<i>Dokumenti 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, neni 16</i>).</p>

	<p>Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcaktonte njësia bazë përkatëse, në vijim pritëshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim (<i>Dokumenti 1.1 Statuti i UNIEL, kreu 6</i>). Zyra e personelit ishte pjesë e të gjitha hallkave të procesit duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme (një PAE dhe një PAK) nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion.</p> <p><i>Dokumenti 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i></p> <p><i>Dokumenti 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, neni 16</i></p> <p><i>Dokumenti 1.1 Statuti i UNIEL, kreu 6</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtari të praktike lidhur me programin e studimit. UE dhe FE kanë marrëveshje të shumta bashkëpunimi me kompani dhe institucione të tjera, në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi. Në dokumentin e dorëzuar portalin e ASCAL, evidentohen 60 marrëveshje me entitete të ndryshme private dhe publike si dhe lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale. Nga takimi i GVJ me përgjegjës të departamentit dhe stafin e angazhuar në këtë program studimi u përmendën mundësitë e kufizuara të studentëve për të zhvilluar praktikën në biznese në zonën e Elbasanit edhe sepse studentët janë të orientuar drejt qytetit të Tiranës. Prandaj dhe në listën e marrëveshjeve të praktikës vihet re një mungesë balance midis marrëveshjeve me sektorin privat dhe publik, në favor të këtij të fundit.</p> <p><i>Dokumenti 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve</p>	<p>Në bazë të marrëveshjeve të bëra me institucionet pritëse për zhvillimin e praktikës, departamenti e pajis studentin me atë që quhet paketë e praktikës. Në këtë dokument paraqiten pritshmëritë e IAL për studentin praktikant por edhe vlerësimi që i bën institucioni pritës studentit sipas një fische vlerësimi. Në dokumentin e ofruar nga IAL paraqitet kjo praktikë si dhe lista e studentëve që kanë kryer praktikën në institucionet pritëse.</p>

/raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<i>Dokumenti 1.25 Paketa e praktikës për programin e studimit "Master i shkencave në menaxhim".pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit por duhet të bëhen përpjekje për balancimin e ngarkesës mësimore. Në mënyrë që stafi të ketë me shumë mundësi për tu angazhuar në kërkim shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në portalin e ASCAL për infrastrukturën e UE dhe Fakultetit të Ekonomisë, GVJ konstaton se insitucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerezore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambjentet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. <i>Dokumenti 3 RVB Tabela 16 Mjediset e Fakultit/Njësia Bazë</i> <i>Dokumenti 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambjentet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambjente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat

<p>të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>e leksioneve dhe seminareve, janë të pajisur me kompjutera e projektorë. (<i>Dokumenti RVB Tabela 16 Mjediset e Fakultit/Njësia Bazë</i>).</p> <p>Godina ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, plotëson kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “<i>Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre</i>”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m²/ student. Në rastin konkret, referuar tabelës së mjediseve të fakultetit dhe RVB normativa në FE-UE është 2m² për student. Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p><i>Dokumenti 3 RVB Tabela 16 Mjediset e Fakultit/Njësia Bazë</i></p> <p><i>Dokumenti 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në këtë program studimi nuk zhvillohen laboratorët, për shkak të tipologjisë së lëndëve që zhvillohen, por gjithsesi, Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ka vënë në dispozicion ambjentet e laboratorëve që gjenden në Fakultet, të cilët janë të pajisur me një sërë softëare.</p> <p><i>Dokumenti 3 RVB Tabela 16 Mjediset e Fakultit/Njësia Bazë</i></p> <p><i>Dokumenti 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Godina ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, disponon një laborator informatike dhe një sallë interneti në funksion të nevojave të studentëve.</p> <p><i>Dokumenti 3 RVB Tabela 16 Mjediset e Fakultit/Njësia Bazë</i></p> <p><i>Dokumenti 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që</p>	<p>Konstatohet se Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtaritë praktike</p>

<p>zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>lidhur me programin. Institucioni dhe Fakulteti kanë marrëveshje të shumta bashkëpunimi me kompani dhe institucione të tjera, në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>Dokumenti 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i></p> <p><i>Dokumenti 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përputhje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion u konstatua se në dispozicion të studentëve ekziston biblioteka, në godinën ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi. Në mjediset e këtyre bibliotekave studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studjuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Gjithashtu, të gjithë studentët dhe personeli akademik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” kanë qasje në përdorimin e Bibliotekës Online “U-Library”.</p>

<p>nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Aksesi në bibliotekën online mundësohet përmes adresës personale të e-mail-it në sistemin EMS në të cilin është regjistruar çdo student apo personel i stafit akademik I UE. Gjithashtu në linkun https://ulibrary.rash.al/ studentëve iu ofrohet tutorial për përdorimin e saj.</p> <p>https://www.uniel.edu.al/biblioteka-online</p> <p><i>Dokumenti 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i></p> <p><i>Dokumenti 2.8 Fondi i librit</i></p> <p><i>Visita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë. Çdo vit akademik, pedagogët mund të depozitojnë kërkesat e tyre për literaturën e nevojshme dhe mbështetëse të re për tu patur në bibliotekë. Po kështu Buletini shkencor i UE është një tjetër mundësi për përditësim të bibliotekës me kërkime dhe punime empirike nga konteksti shqiptar.</p> <p><i>Dokumenti 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i></p> <p><i>Dokumenti 2.8 Fondi i librit</i></p> <p><i>Dokumenti 3 RVB</i></p> <p><i>Visita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar akses të veçantë në biblioteka online të tilla si: JSTORE, U-Library, aksesimi nëpërmjet account që studentët kanë në EMS garanton barazi në akses për literaturë të huaj si për programin e studimit në fjalë por edhe për UE në përgjithësi. <i>Dokumenti 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha</p>	<p>Biblioteka ishte përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike në shqip dhe anglisht. Studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës e pajisur me kompjutera dhe akses në internet. Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë. Çdo vit akademik, pedagogët mund të depozitojnë kërkesat e tyre për literaturën e nevojshme dhe mbështetëse të re për tu patur në bibliotekë.</p> <p><i>Dokumenti 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i></p> <p><i>Dokumenti 2.8 Fondi i librit</i></p>

moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<i>Visita në IAL</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka krijuar akses të veçantë në biblioteka online të tilla si: JSTORE, U-Library, aksesimi nëpërmjet account që studentët kanë në EMS garanton barazi në akses për literaturë të huaj si për programin e studimit në fjalë por edhe për UE në përgjithësi. Aksesimi bëhet pa pagesë. <i>Dokumenti 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është duke iu nënshtruar procesit të digjitalizimit nëpërmjet një projekti të përbashkët mes Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe he UE. Ky projekt do të pajisë bibliotekën me programe kompjuterike të cilat do të mundësojnë përdorimin e bibliotekës nga të gjithë studentët. <i>Dokumenti 4.10 Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës UNIEL</i> <i>Dokument 3 RVB</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ evidentoi se biblioteka përdoret nga studentët e këtij programi studimi. Biblioteka kryesore pranë Rektoratit të UE zhvillon aktivitetin e saj duke organizuar punën në 2 turne nga 08.00 deri në 19.00 për të qenë në funksion të nevojave të studentëve dhe stafit akademik që zhvillojnë mësimin mbasditë, ndërsa ditën e shtunë biblioteka qendrore është e hapur në orarin 8:00-16:00, gjithashtu është i afishuar dhe orari i bibliotekës së FE të Hënën –ditën e premte 08:00-16:00. <i>Dokumenti 4.11: Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik	Aderimi në bibliotekën Jstore si një produkt i bashkëpunimit me Fondin Amerikan të Zhvillimit AADF, aktualisht ofrohen më shumë se 12 milion artikuj në revista akademike, 85000 libra dhe 2 milion dokumente burimore primare në 75 disiplina duke përfshirë formatet e revistave, librave, dhe koleksione dokumentesh. Ky element përmendet si arritje institucionale në raportin e analizës instucionale të UE. Në portalin e ASCAL, IAL ka vënë në dispozicion edhe fondin e librave për secilën njësi kryesore në UE. Ky fond nuk është i detajuar sipas programeve të studimit por në nivel fakulteti. IAL nuk disponon

dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	një praktikë të shkallës së shfrytësimit të fondit fizik dhe fondit online nga studentët e programit të studimit për të gjykuar për efektivitetin e sallave të studimit. <i>Dokumenti 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL bën përpjekje të vazhdueshme për pajisur dhe përditësuar literaturën në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon një sërë procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin. Sekretaria mësimore disponon një sistem kompjuterik menaxhimi dhe administrimi të informacionit të studentit nga krijimi i kartelës dhe rregjistrimi i parë deri në diplomim të tij (sekretaria online). Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajiset me numër matrikullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e Universitetit në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ

	<p>verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.</p> <p><i>Dokumenti 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në UNIEL, neni 10</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar takimit të zhvilluar të GVJ me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto të dhëna ruhen kryesisht në formë manuale por edhe elektronike në disa njësi të Universitetit si departamenti, fakulteti, universiteti, zyra e burimeve njerëzore etj.</p> <p><i>Dokumenti 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në UNIEL,</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik dhe ndihmës akademik, komunikojnë me studentët nëpërmjet email-ve sikurse edhe nëpërmjet EMS. Në sistemin EMS kryhen këto procese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hedhje, përditësim i të dhënave të studentëve; • Regjistrimi në lëndë; • Përcaktimi i statusit të studentit; • Komunikimi i personelit me studentët (chat ose mesazhe); • Hedhja dhe përditësimi i të dhënave financiar; • Hedhja e të dhënave kalendarike të provimeve; • Monitorim mbi hedhjen e notave etj; <p>Ne rregulloren për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit në edukim në UE paraqiten proceset rregulluese në lidhje me EMS. <i>Dokumenti 4.12 Rregullorja EMS</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi EMS përfshin edhe komunikim interaktiv por sipas raportimit në RVB ato nuk janë akoma të aktivizuar. Ndërkohë gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19 i gjithë sistemi i komunikimit u realizua nëpërmjet platformës Microsoft Teams. Gjatë vizitës që GVJ pati në Institucion, në takimin me stafin akademik të programit u evidentua se që nga periudha e pandemisë Covid-19 e në vazhdim, stafi akademik dhe studentët komunikojnë ndër të tjera edhe nëpërmjet platformës Teams. Në këtë platformë, pedagogët mund të informojnë studentët në</p>

	<p>lidhje me gjithcka për lëndët përkatëse si edhe vendosin leksionet, materialet bazë apo ndihmëse, raste studimi etj.</p> <p><i>Dokumenti 4.12 Rregullorja EMS</i></p> <p><i>Dokumenti 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në Departamentin e Adminstrim Biznesi, bëhet nga përgjegjësi i departamentit. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimi, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në fakultet. Gjatë takimit që GVJ pati në institucion, u evidentua se përveçse platformave EMS dhe Teams, synohet drejt një sistemi menaxhimi më të konsoliduar për mbajtjen e të dhënave, monitorimin dhe koordinimin midis të gjithë stafit akademik, ndihmës akademik e administrativ brenda Fakultetit.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga konstatimi i GVJ faqja ëeb zyrtare e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” https://www.uniel.edu.al/ (https://uniel.ems.al/school/programlist.aspx) si edhe ajo e Fakultetit, ndër të tjera, përfshin informacion lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që UE-FE disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se IAL harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Buxheti financiar shqyrtohet nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve në nivel institucional dhe jo në nivel njësie kryesore.</p> <p><i>Dokumenti 3 RVB</i></p> <p><i>Dokumenti 2.3 Miratimi i Buxhetit 2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në planin financiar përfshihen</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ardhura: buxheti i shtetit, tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, të ardhura nga shërbime të ndryshme të kryera, donacione e burime të tjera etj; - shpenzime: për pagat, shpenzime operative, sigurimin e cilësisë, pasurimin e bibliotekës etj; <p>Të gjitha kategoritë e këtij kriteri janë të përfshira në këtë plan buxhet. Po kështu Departamenti dorëzon pranë njësisë kryesore një plan buxhet për mbështetjen e kërkuar nga IAL në funksion të mbarëvajtjes së departamentit dhe programeve të studimit që ai menaxhon.</p> <p><i>Dokumenti 3 RVB</i></p> <p><i>Dokumenti 2.3 Miratimi i Buxhetit 2022</i></p> <p><i>Evidenca 4.16 Kërkesa për parashikime financiare për buxhetin e vitit departamenti i Administrim-Biznes-it.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike Sektori i Auditit të Brendshëm pranë UE, bën relacion mbi projekt buxhetin por në evidenca nuk paraqitet një document i auditit të brendshëm. Ndërkohë IAL ka vënë në dispozicion të GVJ raportin e Auditit të zhvilluar nga KLSH.</p> <p><i>Dokumenti 4.14 Raporti i Auditit KLSH 2022</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><i>Dokumenti 3 RVB</i></p> <p><i>Dokumenti 2.3 Miratimi i Buxhetit 2022</i></p> <p><i>Evidenca 4.16 Kërkesa për parashikime financiare për buxhetin e vitit departamenti i Administrim-Biznes-it.pdf</i></p>
---	--

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ, duke ju referuar RVB, evidenton se Institucioni dëshmon dhe garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, megjithatë IAL duhet të bëjë përpjekje në diversifikimin e të ardhurave duke qënë se nurmi i studentëve ka një trend jo pozitiv, aspekt i hasur në shumicën e IAL-ve në Shqipëri.</p> <p><i>Dokumenti 3 RVB</i></p> <p><i>Dokumenti 2.3 Miratimi i Buxhetit 2022</i></p> <p><i>Evidenca 4.16 Kërkesa për parashikime financiare për buxhetin e vitit departamenti i Administrim-Biznes-it.pdf</i></p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson që UE garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Por gjithashtu vlerësojmë që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për t'u diferencuar në treg në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e programit dhe të ardhurat që vijnë nga studentët.</p>
---------------------------	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë VKM Nr 80 të vitit 2015, UE ka sanksionuar në rregulloret e tij në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti një sërë rregullash dhe procedurash që shoqërojnë studentin nga momenti që vendos të aplikojë për programin MSHM deri në diplomimin e tij.</p> <p>Në <i>nenin 12 dhe 14</i> të Rregullores së Fakultetit Ekonomik studentët gjejnë të shprehur elementët kryesorë të informacionit mbi programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim. <i>Ashtu siç kemi dhe më lart, Departamenti AB duhet të hartojë rregulloren e programit të studimit MSHM.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Njësia e Karrierës dhe Alumnit, si pjesë e Drejtorisë Juridike, Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në përputhje dhe me <i>nenin 15</i> të Rregullores së Institucionit, luan një rol shumë të rëndësishëm për këshillimin e studentëve në system (atyre që studojnë BA në UE) dhe të aplikantëve të tjerë.</p> <p>Rregulloret në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë si dhe modalitet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore, bëjnë të mundur garantimin e barazisë në hyrje dhe në trajtim të studentëve gjatë periudhës së studimeve deri në diplomim.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore,</p>	<p>Departamenti si rregull propozon çdo vit kuotat dhe kriteret e pranimit, bazuar në kriteret ligjore, kapacitetet njërzore dhe ato infrastrukturore dhe më pas ato miratohen në Senat. Duhet thënë që në lidhje me këtë program studimi nuk ka kritere shtesë, përpos atyre ligjore për t'u pranuar apo për të transferuar studimet.</p> <p>Në vlerësimin e ekspertëve, në vitet e fundit, për shkak të dinamikave ekonomike dhe sociale, në përgjithësi në programet</p>

sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	master kriteret e pranimit mbeten kryesisht vetën ato ligjore në IAL.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në nivel njësie bazë, bëhet një punë e vazhdueshme me studentët e BA, për t'i orientuar në studimet master, ndërkohë që departamenti ka hartuar dhe një politikë marketingu. Gjithashtu, përmes ËEB, faqes zyrtare të facebook synohet të promovohet programi. <i>Nën këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm, mund të shihen dhe forma të tjera të promovimit, sepse një master në MSHM mund të kryqëzohet me shumë programe studimi Brenda UE.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Ndërkohë që dhe bashkeveprimi me industrinë dhe organizatat lokale, mund të jetë një hapësirë që duhet parë si oportunitet për studentë dhe për procese të tjera. <i>Dokumenti 1.2: Rregullorje UE</i> <i>Dokumenti 1.7: Rregullore e FEUE</i> <i>Dokumenti 1.15: Rregullore e departamentit të AB</i> <i>Dokumenti 1.16: Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore</i> <i>Dokumenti 1.20: Vendim për miratimin e kuotave të pranimit në programin e studimit</i> <i>Dokumenti 1.21: Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit në programin e studimit</i> <i>Dokumenti 1.26: Politika e marketingut për programin MSHM</i> <i>Dokumenti 4.13: Të dhëna mbi publikimin në faqen e ËEB</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në lidhje me kriterin 6 dhe 7, duhet thënë që institucioni respekton aspektet ligjore të cilat përcillen vit pas vit inga MAS në lidhje me pranimin e kandidatëve që vijnë nga vendet fqinjë shqipfolëse dhe më gjerë, individët me aftësi të veçanta dhe individë që vijnë nga shtresat e marxhinalizuara.

<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Vendimi për kuotat e pranimit të kategorive të studentëve si më lart merret në përputhje me rregulloret e institucionit në senat, pas propozimeve që vijnë nga njësitë kryesore/bazë.</p> <p><i>Dokumenti 1.2: Rregullorje UE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullore e FEUE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.15: Rregullore e departamentit të AB</i></p> <p><i>Dokumenti 5.1: Vendimi senatiti për kapacitetet 2022-2023</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren e UE dhe në respekt të aspekteve ligjore dhe administrative, Bordi Administrimit merr vendime në lidhje me ndihmën/mbështetjen e studentëve në ciklin bachelor dhe master.</p> <p><i>Dokumenti 5.2. Vendimi i Bordit të administrimit për bursat dhe përjashtimet</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson së në lidhje me këtë standardin "Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit" UE ka formalizuar përmes rregulloreve dhe procedurave të gjitha elementët nga pranimi deri në diplomim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UE, në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik pasqyrohen në mënyrë të hollësishme procedurat e përparimit akademik.</p>

<p>procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p><i>Kreu IV – Organizimi i Studimeve që përmban: organizimin e mësimdhënies; frekuentimin, organizimin e praktikave, kalimin në vitin pasardhës, etj;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p><i>Kreu V – Kontrolli i dijës dhe vlerësimi përmban format e vlerësimit të dijës, afatet e provimeve, kushtet e hyrjes në provim, ankimimin, riprovimin përmirësimin dhe mbartjen.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p><i>Kreu VI – i referohet gjithë procedurave të transferimit, njohjes dhe njehsimittë periudhave të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p><i>Kreu VII – ka të bëjë me fitimin, pezullimin dhe përfundimi i statutit të studentit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve qartësohen në silabusin e çdo lëndë dhe përbëhen nga vlerësimi për angazhimin në seminare/detyra e kursit/provimi ndërmjetëm dhe përfundimtar.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë në ditët e informimit; në sistemin e brendshëm EMS, si dhe në vijimësi nga çdo pedagog në mësim në përputhje me silabuset e lëndëve.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Në <i>kreun VIII</i> të Rregullores së FE, përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që student mund ta mbrojë atë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimeve me stafin e departamentit të Administrim – Biznesit, takimeve me sekretarinë mësimore dhe studentët që ndjekin MSHM, vlerësuam që përgjithësisht që rregulloret, procedurat dhe sistemet funksionojnë në plotësimin e veprimtarive mësimore të studentëve.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumenti 1.2: Rregullore UE</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja e FE</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 13 – Format e vlerësimit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumenti 3.10: Sillabuset e lëndëve shqip dhe anglisht</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumenti 1.16: Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se në lidhje me standardin “Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik,</i></p>

	<i>njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program” njësia kryesore dhe bazë ka ngritur strukturën e rregulloreve, sistemin EMS, ka vendosur në silabus elementët e duhur dhe ka ngritur punën në sekretarinë mësimore, në përmbushje të plotë të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje të plotë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët kanë disa rrugë për t'u informuar për përmbajtjen e programit MSHM. Fillimisht është web i universitetit, fletëpalosjeve, komunikimit të drejtpërdrejtë në departamenti, përfaqes komunikuese të njësisë së karrierës dhe alumnit, faqes së fcb dhe instagramit, etj.</p> <p>Programi përmban 120 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve plotësuese, lëndë më zgjedhje; praktikës mësimore dhe detyrimit përmbyllës të diplomës. Mësimi organizohet në 4 semestra, çdo semestër përmban 30 ECTS dhe zgjat 15 javë.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Një burim tjetër i rëndësishëm informacioni është silabusi i lëndëve i cili qartëson llojin e lëndës, numrin e krediteve, semestrin në të cilin zhvillohet, mënyrën e vlerësimit të njohurive, detyrimet e lëndës, frekuentimin.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e UE dhe FEUE, studentët gëzojnë të drejtën të përfundojnë studimin në MSH në një afat ligjor që është dyfishi i periudhës së studimit, kuptuar deri në 4 vite nga momenti i nisjes, përjashtim nga ky rregull bëhet në rastin kur student pezullon studimet e tij për një afat të caktuar kohor për rrethana të caktuara në jetën e tij.</p>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për	

zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

Departamenti përcakton dhe koordinatorin e programit, i cili në thelbin e veprimtarisë së tij është një ndërlidhës i rëndësishëm i studentit me departamentin dhe gjithë procesin akademik.

Gjithashtu, në përputhje me Statutin e UE dhe Rregulloren e UE, Sekretaria mësimore dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit suportojnë studentët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre.

Përmes sistemit EMS studentët informohen kryesisht mbi vlerësimin dhe informacione pjesore. Në UE mungon një sistem LMS, i cili do të mundësonte informacionin e plotë mbi përmbajtjen e lëndëve, leksionet, seminarët dhe do të krijonte një ndërveprim të rëndësishëm me studentët. Gjithashtu, sistemi do krijonte mundësinë për vlerësimin dhe "auditimin" e gjithë përmbajtjes së lëndëve dhe elementë të tjerë të punës së pedagogut.

Gjithashtu, në takimin me studentët u evidentua një lloj paqartësie dhe apatie, në shpjegimin e asaj çfarë ndodh gjatë studimit.

Dokumenti 1.2: Rregullore UE

Dokumenti 1.1: Statuti UE

Dokumenti 1.7: Rregullorja e FE

Dokumenti 3: RVB,

Dokumenti 3.10: Silabuset e lëndëve shqip dhe anglisht

Dokumenti 6, 7 në dokumentat shtesë: Silabuset

Dokumenti 1.16: Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore

Dokumenti 4.12: Rregullorja EMS

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.

Në nivel universiteti është ngritur njëسيا e Karrierës dhe Alumnit, e cila funksionon prej rreth i viti.

Veprimtaritë e para kanë filluar të ndodhin, por duhet një ndërveprim më i madh dhe nga ana e departamentit dhe fakultetit, veçanërisht në rritjen e bashkëpunimit me bizneset e qarkut, por dhe më tej.

Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit" mbetet më shumë për të bërë për të vënë studentin në qendër.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e UE çdo fakultet ka brenda njësinë e administratës, Sekretarinë Mësimore. Sekretaria Mësimore funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, mbi këtë bazë njësia kryesore ka formuluar Rregulloren e Sekretarisë për FEUE, që në setin e dokumentave të vendosura në platformën e ASCAL vjen si rregullore për krijimin, rregjistrimin, ruajtjen dhe dorëzimin e dokumentave në UNEL
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS.Mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vite akademike është:

Emri i programit	Viti Akademik	Studentë të regjistruar	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar	Studentë të diplomuar	Nota mesatare në dalje
Msc Menaxhim	2019-2020	16	6.55	-	9	7.83
	2020-2021	18	6.35	-	13	7.16
	2021-2022	20	5.98	-	8	7.95
	2022-2023	22				

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë mësimore. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, regjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtuam dhe mbajtjen e të gjithë informacionit në mënyrë elektronike përmes sistemit EMS.

Dokumenti 3: RVB, Tabela 21

Dokumenti 3.6: Rregullore për krijimin, rregjistrimin, ruajtjen dhe dorëzimin e dokumentave në UNEL

Dokumenti 1.16: Modalitetet e funksionimit dhe organizimit të sekretarisë mësimore

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit

Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore si pjesë e njësisë së Administratës të FEUE, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i rregjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës.

Gjatë vizitës në sekretarinë e studimeve master, dosjet fizike dhe “dosjet elektronike”, rregjistrat, proces-verbalet, regjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e

dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>UE, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore, me një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi.</p> <p>Një Raport tjetër i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamentit, një raport tjetër në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur është ai i gjurmimit të studentëve pas diplomimit, të dhënat e të cilit duhet të shërbëjnë dhe për të përditësuar programin.</p> <p><i>Dokumenti 1.12: Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i> <i>Dokumenti 1.24: Analiza vjetore e departamentit 2020-2021</i> <i>Dokumenti 5.24: Harta e punësimit të studentëve</i></p>			
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me këtë standard vlerëson se UE administron gjithë informacionin në lidhje me studentët, nga pranimi, ecurinë e tyre në proces, deri në diplomimin e tyre dhe më tej si alumni në përputhje me bazën ligjore, një sërë rregulloresh të brendshme dhe raportime në nivel institucional dhe departamenti. Standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e

Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Në Statutin e UE dhe në Rregulloren e Organizimit dhe funksionimit të tij (*Kreu II dhe IV*) nene të caktuara i

<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>dedikohet të drejtës së studentëve të përfaqësohen në organet e UE, me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe. Sipas Statutit të UE, në Senatit Akademik bëjnë pjesë dhe studentët, përfaqësuesit e të cilëve zgjidhen përmes votimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjithashtu, studentët janë pjesë e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë; -komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët; grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc që mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë;</p> <p>Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë Këshillat e Studentëve të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimmarrje.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në disa komisione, në Senat, në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programeve, MSHM.</p> <p><i>Pjesë e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të tij, që krijon mundësi e analizave të mëtejshme, por që në formën që bëhet është shumë gjeneralist, nuk është në terma të përmbajtjes së lëndës, të mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, duke mos kontribuar drejtpërdrejtë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës dhe dinamikës gjatë studimeve.</i></p> <p><i>Duhet bërë më shumë për të krijuar traditën e fokus grupeve, mbledhjeve peridoke dhe mbështetjes për hapat më tej të karrierës së studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe</p>	<p><i>Dokumenti 1.1: Statuti UE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.4 : Rregullore UE</i></p> <p><i>Dokumenti 3.1: Lista e anëtarëve të senatit akademik</i></p> <p><i>Dokumenti 2.2: Rregullore e Këshillit Studentor</i></p>

kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	<p><i>Dokumenti 5.16: Vendimi për Komisionin e Studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 5.17: Vendimi për Komisionin e garantimit dhe mbrotjes së cilësisë</i></p> <p><i>Dokumenti 3: RVB, Tabela 24 të dhëna për anëtarët e NJSBS</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre" vlerëson që përtej pjesës formale ka hapësira për përmirësim dhe ndërveprim real, pyetësi i vlerësimit të procesit mësimor dhe stafit duhet</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rreguloret intitucionale në nivel universiteti dhe fakulteti, në shërbim të informimit të studentit dhe të përparimit të tij në sistem nga momenti që kërkon informacion mbi programin, deri në diplomimin e tij, janë një sërë zyrash brenda njesisë kryesore dhe në rang universiteti.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe	Kështu, Zyra e Këshillimit të Karrierës (ndonëse funksionin prej 1 viti), Sekretaria Mësimore e Fakultetit, Zyra e Financës, Zyra e IT, vetë departamenti, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë i shërbejnë "udhëtimit" të studentit në MSHM, por dhe oportunitetit për Erasmus Exchange në një nga universitetet perëndimore.

<p>asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p><i>Ekspertët vlerësojnë që njësia e karrierës dhe alumnit mund të alokohej, apo të kishte përfaqësues të alokuar dhe në FE, ndërveprimi dhe komunikimi vazhdueshëm është shumë i rëndësishëm për të prodhur rezultat.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit të ekspertëve. në FEUE me studentët, evidentuan që studentët në përgjithësi u shprehën pozitivë për eksperiencën e tyre në programin MSHM, ndonëse dukeshin konfuzë për kompetencat që program ofron dhe për perspektivën që ata kanë në tregun e punës.</p> <p><i>GVJ sugjeron më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë nxitje për studentët që të aplikojnë për Erasmus, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p><i>Dokumenti 1.2: Rregullore UE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.1: Statuti UE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.7: Rregullorja e FE</i></p> <p><i>Dokumenti 1.16: Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>Dokumenti 5.18: Pyetësori i studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 5.14: Harta e punësimit të studentëve</i></p> <p><i>Dokumenti 5.20: Drejtoria Juridike, Marrëdhënie me jashtë dhe alumnit e karrierës</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët" vlerëson që ka vend për përmirësim, më shumë ndërveprim e fokus të studenti. Si u permend me lart GVJ sugjeron më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë</i></p>

	<i>nxitje për studentët që të aplikojnë për Erasmus, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përfundimisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përfundimisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>UE ka një kohë të gjatë në tregun universitar në Shqipëri dhe konsiderohet si qendra e formimit pedagogjik, mësuesisë dhe metodave të mësimdhënies. GVJ vlerëson që ky aspekt duhet të zhvillohet më shumë sepse mund të përbëjë një kriter diferencimi në tregun universitar. Hapja LLL CENTRE, Qendra për të mësuarit gjatë gjithë jetës e tregon më së miri këtë aspekt. Gjithashtu pjesëmarrja e pedagogëve të angazhuar në programin e studimit MSHM, në projekte për ndërtim kapacitetesh tregon gjithashtu perspektivën e stafit dhe rëndësinë që këta të fundit iu japin metodave të mësimdhënies të bazuara në kompetenca. Megjithatë institucioni ka hartuar në nivel instiucional një udhëzues për përdorimin e platformave online, si Microsoft Teams që lindi si nevojë gjatë Covid 19, kjo nuk është e mjaftueshme pasi vlerësojmë që institucioni nuk duhet të limitohet vetëm në këtë aspekt dhe duhet të bëjë më shumë për tu pajisur në nivel institucional me metoda të ndryshme inovative në fushën e mësimdhënies.</p> <p><i>Dokumenti 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i></p>

	<i>Dokumenti 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në nenin 71 të statutit të UE paraqiten elementët e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Komisionet e cilësisë në UE organizohen në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Në vitin 2021 me vendim të Senatit Akademik të UE (Nr 26, datë 27.07.2021) janë miratuar komisionet e përhershme të cilësisë në nivel UE. Këto komisione do të jenë përgjegjëse për garantimin e cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit në nivel institucional. Komisioni ka në përbërje pedagogë nga të gjitha njësitë kryesore të UE.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 24 i Statutit të UE-së, Vendimit të Senatit Akademik nr. 26, datë 27.07.2021 “Për miratimin e përbërjes së komisionit të përhershëm në nivel institucional për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit”, Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit miraton formatin dhe modalitetet e pyetësorit institucional të studentëve “Për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UE. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka këto detyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies; • Bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore; • Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi; <p>Si shihet ngritja e strukturave të monitorimit të cilësisë janë të reja në kohë dhe IAL duhet të bëjë përpjekje për të krijuar praktika efektive diverse të monitorimit të cilësisë në funksion të përmirësimit të cilësisë. Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në Njësinë e Sigurimi të cilësisë u vu re mungesa e praktikave për shkak të mungesës së eksperiencës me këto procedura. Pavarësisht kësaj mungese u vu re një qasje pro-aktive për të krijuar dhe përmirësuar procedurat e monitorimit, dokumentimit</p>

	dhe reflektimit të rezultateve në proceset e përmirësimit të programeve të studimit. <i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022 .</i> <i>Dokumenti 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, dokumentohen duke ju vënë në dispozicion drejtuesve të njësisë dhe kryesore por nga analiza e dokumentave të vëna në dispozicion vihet re vetëm analiza e pyetësorit drejtuar studentit në të gjitha njësitë kryesore të UE përfshirë këtu edhe rezultatet e pyetësorit të FE. Por se si këto rezultate janë përdorur në qëllim të përmirësimit të programit të studimit nuk mund të vlerësohet pasi mungojnë evidenca. Po kështu nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi mungonte feedback që ata kanë sepse ata nuk janë të informuar sa duhet për procesin dhe rolin që ata kanë në përmirësimin e programit të studimit. <i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ nuk mund të japë vlerësim në lidhje me këtë kriter pasi mungojnë evidenca për këtë pikë. <i>Prandaj është e nevojshme që njësia e sigurimit të cilësisë të krijojë mekanizma për ta vlerësuar dhe promovuar më pas.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të institucionalizuar procesin e matjes, krijimi të indikatorëve dhe më pas monitorimit e vlerësimit të cilësisë për programin e studimit në fjalë dhe në përgjithësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 24 i Statutit të UE-së, Vendimit të Senatit Akademik nr. 26, datë 27.07.2021 “Për miratimin e përbërjes së komisionit të përhershëm në nivel institucional për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit”, Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit miraton formatin dhe modalitetet e pyetësorit institucional të studentëve “Për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UET. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka këto detyra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies; 2. Bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore; 3. Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi; <p>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për të hartuar indikatorë të matjes së cilësisë që bëjnë të mundur monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Dokumentimi 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022 .</i></p> <p><i>Dokumentimi 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për</p>	<p>IAL ka ngritur aktet rregullatore në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015, <i>Kreu X</i>, Neni 103 “Sigurimi i brendshëm i cilësisë” megjithatë nuk mund të evidentohet nëse ka një plan masash për të monitoruar cilësinë e programeve të studimit dhe instrumentat që do të përdoren për ta vlerësuar dhe monitoruar atë.</p>



<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Universiteti në nivel fakulteti si edhe Departamenti, ka realizuar takime me biznese dhe ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. <i>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për ta bërë aktiv këtë component.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Ky proces vlerësimi i jashtëm por edhe RVB i realizuar nga stafi i njësisë kryesore dhe bazë ka për qëllim ta ndihmojë institucionin të përmirësojë praktikën në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Nga takimet me stafin e angazhuar në programin e studimit u pranua se më shumë praktika duhen dokumentuar dhe institucionalizuar dhe se proceset e akreditimit janë një mënyrë për të nxitur IAL-në në këtë drejtim.</p> <p>Akreditimi institucional dëshmon që IAL është në drejtimin e duhur dhe se çdo strukturë përbërëse e IAL duhet të bëjë përpjekje për tu pajisur me mekanizma dhe indikatorë të matshëm të cilët më pas i japin mundësinë IAL-së , të masë, analizojë, krahasojë dhe përmirësojë programin e studimit ne menyre periodike.</p> <p><i>Dokumenti 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, RVB dhe vizita në IAL vihet re se akoma instiucioni nuk ka konsoliduar një paketë indikatorësh dhe plan aktiviteti për procesin e monitorimit të cilësë përveç pyetësorit të studentëve. Këtij të fundit duhet ti bashkëngjiten edhe instrumenta të tjerë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Akreditimi institucional dëshmon që IAL është në drejtimin e duhur dhe se çdo strukturë përbërëse e IAL duhet të bëjë përpjekje për tu pajisur me mekanizma dhe indikatorë të matshëm të cilët më pas i japin mundësinë IAL-së , të masë, analizojë, krahasojë dhe përmirësojë. Gjithashtu, GVJ vlerëson</i></p>

	që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të hartuar një paketë dhe plan veprimi periodik për monitorimin e cilësisë së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UE ka përdorur pyetësin e studentëve si një instrument për të vlerësuar cilësinë. Pyetësi vlerësohet për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmban pyetjet e mëposhtme.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si e vlerësoni informacionin që keni për programin dhe objektivat e lëndës? 2. Si e vlerësoni ju përcaktimin e krediteve për çdo lëndë? 3. Si e vlerësoni menaxhimin e orës mësimore nga pedagogët? 4. Si e vlerësoni qasjen në bibliotekë dhe në materialet studimore? 5. Si e vlerësoni cilësinë e programit tuaj të studimit për të hyrë në tregun e punës? 6. Si e vlerësoni raportin midis leksioneve, seminareve, punëve të laboratorit dhe praktikave mësimore? 7. Si e vlerësoni rekomandimin me literaturë të huaj nga ana e pedagogëve? 8. Si e vlerësoni mënyrën e zhvillimit të provimeve? 9. IAL ka kryer analizën e rezultateve dhe ka dalë dhe rekomandime por se si këto rekomandime janë reflektuar në programin e studimit për këtë nuk ka një praktikë. 10. Si e vlerësoni mënyrën e vlerësimit të studentëve prej pedagogëve 11. Si e vlerësoni metodologjinë e mësimdhënies së përdorur nga pedagogët? 12. Si e vlerësoni gatishmërinë e pedagogëve për sqarime dhe konsultime?

	<p>13. Si e vlerësoni përfshirjen e profesorëve të huaj në mësimdhënie gjatë vitit akademik?</p> <p>14. Si e vlerësoni performancën e pedagogëve në leksione,seminare, laboratore?</p> <p><i>GVJ rekomandon përdorimin e pyetjeve të kontrollit për të kuptuar më mirë rezultatet dhe për të rritur cilësinë e tyre. Gjithashtu përdorimin e anketimeve alternative, psh fokus grupe.</i></p> <p><i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Si u përmend më sipër IAL realizon pyetëtorin e studentëve si detyrim institucional, rezultatet analizohen, <i>por nuk ka praktikë për përfshirjen e rezultateve për të motivuar apo marrë masa të caktuara në vijim të përmirësimit të cilësisë.</i></p> <p><i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime</p>	<p>Përpos realizimit të pyetësorit të studentëve, njësitë bazë realizojnë vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të studentëve sa i përket psh mesatares në hyrje dhe dalje, punësimit të tyre etj. Ndërkohë që kryejnë testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Dokumenti 5.7 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021</i></p> <p><i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p>

Erok

[Signature]

<p>ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, RVB dhe vizita në IAL përveç anketimit të studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe performancës së pedagogut, nuk evidentohen metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe, intervista të hapura, fokus grupe etj.</p> <p><i>GVJ sygjeron kryerjen e sondazheve por edhe aplikimin e planeve të veprimeve në rast të evidentimit të mangësive, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</i></p> <p><i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, por ky proces duhet të pajiset me praktika monitoruese dhe vlerësuese për të siguruar një analizë të vazhdueshme të programit të studimit. Këtë konkluzion e ka nxjerrë edhe vet IAL në rekomandimet e paraqitura në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.4



Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UE ka ngritur strukturat për sigurimin e cilësisë të institucionit në përputhje Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj. Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet në nivel strategjik pra në statut të UE dhe rregullore të FE ngritja e këtyre strukturave por nuk ka një rregullore të posaçme për standartet e sigurimit të cilësisë së brendshme. Kjo vjen edhe për shkak të kohës së shkurtër që strukturat janë ngritur në nivel institucional. Si u përmend edhe më lart, nga vizita në IAL u kuptua fryma pozitive dhe angazhimi për ta çuar përpara këtë proces.</p> <p><i>Dokumenti 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL (2)</i></p> <p><i>Dokumenti 5.11 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Mungesa e një rregullore të NJSBC-së e bën të vështirë të kuptuarin sa i përket detyrave konkrete të kësaj njësie dhe shpërndarjen e aktiviteve në strukturat e posaçme që ofrojnë informacion për të vlerësuar programin e studimit në vazhdimësi.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesi është njësi bazë përgjegjëse për cilësinë e programit. Përfshirja e anëtarëve të tij në procesin e vlerësimit të programit të studimit MSHM është një mënyrë përfshirje dhe angazhimi për të përmirësuar në vazhdimësi cilësinë. Megjithatë, GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë përpjekje për të rregulluar procesin e vlerësimit në një plan 360 gradë në të gjithë komponentët e programit të studimit. Kjo e fundit patjetër që kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve që kanë lidhje direkte dhe indirekte me programin e studimit dhe</p>

administrative dhe studentëve të programit të studimit.	përmirësim të vazhduar të institucionalizimit të proceseve që lidhen me të.								
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga vizita në IAL u kuptua që ky kriter plotësohej për proceset e vlerësimit që janë realizuar deri tani, përmendim këtu që IAL ka kaluar një proces të vlerësimit dhe akreditimit institucional. Ky i fundit e ka ndihmuar institucionin të identifikojë fushat e përmirësimit në procesin e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Evidentimi si pikë e dobët dhe më tej si rekomandim në procesin e vlerësimit dëshmon hapin e parë në procesin e vlerësimit (<i>Referencë Dokumenti 3 RVB, pikat e dobëta dhe rekomandimet</i>)								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga vizita në IAL dhe shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet që ekspertë të jashtëm apo bashkëpunëtorë të tjerë nuk janë të përfshirë në procesin e vlerësimit. Kjo vjen edhe për shkak sepse IAL është në hapat e para të konsolidimit të këtij procesi. Megjithatë GVJ këshillon që aktorët e biznesit të zonës së Elbasanit të cilët kanë qenë pjesë aktive me leksionet e tyre të hapura mund të jëne një process pooling paraprak për ti përfshirë në këtë proces. (<i>Dokument 4.6 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit për vitin akademik 2021- 2022</i>)								
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL ka bërë përpjekje për të përfshirë njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit por ky proces ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm në drejtim të: praktikave të vlerësimit, institucionalizimit të tyre si dhe përfshirjes së një baze të gjerë studentësh dhe aktorë me ekspertizë në tregun e punës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të zyrës së NJSBC, na u prezantuan sektorët (Sektori i kurrikulave, Sektori i statistikave dhe Sektori i NJSBC-së). Ndër aktivitetet e përmendura ishin: miratimi i kurrikulave, kontrolli për respektimin e standartave shtetërore, shpërndarja mësimore nëse kjo e fundit bazohej te udhëzimi 29, respektimi i ligjit për paraqitjen e syllabuseve konform shtojcës 2 të VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 etj. Megjithatë nga takimi nuk u evidentua nëse IAL aplikonte një plan masash dhe aktivitësh të tjera që janë të nevojshme për vlerësimin e programit të studimeve. Psh nuk kishte një praktikë të vlerësimi të silabuseve përpos dispozitës ligjore.</p> <p><i>GVJ rekomandon pajisjen me instrumenta të tjerë për të vlerësuar dhe aspekte të përmbajtjes së sillabusit dhe jo vetëm ato të formës.</i></p> <p>Në vijim të kësaj logjikë, një pikë e fortë në cilësinë e një programi është përfshirja e punimeve të pedagogut të lëndës në silabus përpos literaturës bazë dhe mbështetëse. Kjo e fundit tregon ekspertizën e pedagogut në fushën që ai mbulon dhe kërkimet empirike të tij iu ofrojnë studentëve një qasje më kontekstuale të moduleve që ata marrin.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ vëren se publikimi i rezultateve të vlerësimi të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin dhe aktet e UE-së. Qëllimi i vlerësimi është paraqitja e të dhënave mbi programet e studimit dhe përmirësimi i tyre. Nga shqyrtimi i raporteve të publikuar në faqen e UE si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cënuar liria akademike apo të dhënat personale.</p> <p><i>Dokumenti 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimi duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p>	<p>Procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen periodikisht dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i paraqiten Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Senatit. Vlerësimet programore e të departamenteve planifikohen për çdo vit akademik bazuar në</p>

mangësive e dobësive të evidentuara.	rezultatet e proceseve të kryer (Takimi me specialistë të NJSBC-së në IAL). <i>Dokumenti 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL (2)</i> <i>Dokumenti 5.11 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nëpërmjet procesit vlerësues synohet: kontrolli i cilësisë, vlerësimi i gjendjes së cilësisë dhe propozime për përmirësimin e saj. <i>GVJ vlerëson që ky proces është në zhvillim e sipër dhe nuk mund të gjykohet akoma për efektivitetin dhe impaktin që ka në sigurimin e cilësisë së programit të studimit MSHM.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni ka organizuar veprimtari në relativisht periodike me personelin dhe me studentët me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Në RVB evidentohen më shumë trajnime në funksion të programit të studimit dhe kompetencave që ai ofron por jo në drejtim të procesit të vlerësimit të cilësisë. Ashtu si u përmend edhe më lart, nga vizita në IAL, stafi u shpesh shumë pozitiv për rëndësinë e procesit dhe po bën përpjekje për të krijuar një paketë instrumentash dhe plan veprimi dhe u përmend gjithashtu që vet procesi i vlerësimit jashtëm është një proces që i vjen në ndihmë përmirësimeve të mëtejshme			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar procesin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së programit të studimit. Realizimi i tyre me efektivitet do të bëjë të mundur krijimin e një kulture të brendshme të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	0 Nuk përmbushet	1 Përmbushet pjesërisht	2 Përmbushet kryesisht	3 Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	0 Nuk përmbushet	1 Përmbushet pjesërisht	2 Përmbushet kryesisht	3 Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në "Menaxhim"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Ndërkombëtarizimi i vazhdueshëm i programit të studimit dhe pjesëmarrja në projekte, i mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga BE-ja, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca tematike;
2. Staf proaktiv dhe i angazhuar për të institucionalizuar proceset që lidhen me cilësinë e programit të studimit;
3. Godina, biblioteka, ambjertet mësimore janë të një standarti të lartë duke krijuar në këtë mënyrë një mjedis të standardeve europiane;
4. Përvoja shumë vjeçare në tregun e arsimit të lartë të programit të studimit;
5. Njohja e rajonit të Elbasanit dhe bashkëpunimi me organizatat/industrinë lokale;

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa e dokumentimit të veprimtarisë kërkimore shkencore në nivel njësie bazë; (*Standardi II.7, kriteri 3*)
2. Në nivel institucional por edhe në nivel njësie bazë të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, nuk kryhen vazhdimisht sondazhe për studentët, stafin akademik dhe atë ndihmës akademik dhe nuk adresohen masat e marra për mangesitë e ndryshme të evidentuara; (*Standardi VI. 1, kriteri 5*)
3. Mungesa e një metodologjie të mirëfilltë për identifikimin e kompetencave aktuale dhe të ardhshme që lidhen direkt me programin e studimit; (*Standardi III.4, kriteri 2*)

Rekomandime

1. GVJ vlerëson që IAL nuk ka evidentuar konkretisht kompetenca dhe aftësi që lidhen direkt me Masterin Shkencor Menaxhim .Kësisoj nevojitet një përmirësim i tij jo vetëm në drejtim të identifikimit të kompetencave konkrete por edhe në shtrirjen e studimit të tregut në një përfaqësim më të gjerë aktorësh. GVJ i rekomandon Departamentit të Administrim Biznesi të hartojë një analizë më të plotë të tregut punës për programin e studimit MSHM;
2. GVJ rekomandon që krahas përmirësimit të metodologjisë së kërkimit të tregut për identifikimin e kompetencave aktuale dhe ato të ardhshme të hartohet dhe një analizë Benchmarking ku të analizohen programe studimi të ngjashme në rajon BE dhe më gjerë të cilat janë përdorur si referencë për ndërtimin e programit të studimit. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të

ngjashme brenda dhe jashtë vendit do t'i shërbejë IAL-së për të përditësuar dhe ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës;

3. GVJ rekomandon që të integrohen në program më shumë koncepte të marketingut digjital, menaxhimit të inovacionit etj dhe të gjithë elementëve që lidhen me digjitalizimin e sipërmarrjeve;
4. GVJ rekomandon që në analizën e kërkimit shkencor të departamentit dhe sidomos të stafit të angazhuar në programin e studimit MSHM të detajohet numri i artikujve i botuar në revista të Clarivate Analytics dhe Scopus si dhe numri i citimeve respektive. Këto të fundit janë tregues reale të cilësisë së kërkimit shkencor;
5. GVJ rekomandon që Departamenti të nxisë stafin në drejtim të krijimit të një profili publik në platforma të promovimit të kërkimit shkencor si Research gate, Scopus, Google scholar pasi jo të gjithë janë prezent në këto platforma;
6. Këshillohet përfshirja e studentëve dhe strukturave të tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Management."

a. Strengths and affirmations:

1. The continuous internationalization of the study program and participation in projects enables academic staff and students to benefit from exchange and interaction with scientific researchers from the EU, including participation in training and thematic conferences;
2. Proactive and committed staff to institutionalize processes related to the quality of the study program;
3. The building, library, and teaching areas are of a high standard, thus creating an environment of European standards;
4. Many years of experience in the higher education market of the study program;
5. Knowledge of the Elbasan region and cooperation with local organizations/industry;

Weaknesses

1. The lack of documentation of scientific research activity at the department level; (*Standard II.7, criterion 3*)
2. At the institutional level but also the level of the basic unit of the department responsible for this study program, surveys are not continuously conducted for students, academic staff and academic assistants, and the measures taken for the various identified deficiencies are not addressed; (*Standard VI.2, criterion 5*)
3. Lack of a structured methodology for identifying current and future competencies directly related to the study program; (*Standard III.4, criterion 2*)

Recommendation:

1. External Evaluation Group (EEG) assesses that HEI has not explicitly identified competencies and skills directly related to the Scientific Master in Management. In this vein, it recommends that the HEI improve identifying specific competencies and extend the market study to a broader representation/involvement of actors. EEG recommends that the Department of Business Administration undertake a complete analysis of the job market for the study program;
2. EEG recommends that in addition to improving the market research methodology for identifying current and future competencies, a Benchmarking analysis should be drawn up where similar study programs in the EU region and beyond will be analyzed, which have been used as a reference for the design of the study program;
3. EEG recommends that the HEI consider adding topics related to digital marketing, innovation management, and other subjects related to the digitalization of enterprises in the study programme;
4. EEG recommends a more detailed analysis of the Department's scientific research and especially of the staff engaged in the study program, such as the number of articles published in Clarivate Analytics, Web of Science and Scopus journals and the number of respective citations should be detailed. The latter are objective indicators of the quality of scientific research;
5. EEG recommends that the Department encourage the staff in terms of creating a public profile on platforms for the promotion of scientific research, such as Research Gate, Scopus, and Google Scholar, as not everyone is presented on these platforms;
6. EEG recommends student involvement in the study program's continuous improvement;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përbushje	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X